20201

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**GJYKATA E RRETHIT TIRANE**
Nr.___Vendimit 20.201

# VENDIM

## PER REGJISTRIMIN SI PERSON JURIDIK

Ne Tirane sot me date 28.10 1998 une Gjyqtare e Gjykates se Rrethit Tirane Gjinule Capo, mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga kerkuesit:

**1.Niko Leka** **2.Edmond Leka** **3.Koço Bode** **4.Gezim Hajdini** **5.Genc Çano**

per regjistrimin si person juridik te shoqerise **"UNION TRAVEL CO."** sh.p.k. dhe:

KONSTATOVA

Se kerkesa e paraqitur nga kerkuesit, **Niko Leka, Edmond Leka, Koço Bode, Gezim Hajdini** dhe **Genc Çano,** per regjistrimin si person juridik te shoqerise tregetare **"UNION Travel Co."** sh.p.k, me administrator z.**Gezim Hajdini**, me kapital fillestar 25,000 USD, me kohezgjatje mbi 10 vjet, me seli ne Tirane, Rr.Muhamet Gjollesha, P.29/89, me objekt te veprimtarise ne fushen e:

1- Agjensi udhetimi turistike, per udhetime tokesore, ajrore dhe detare.
- Organizimin e udhetimeve per qellime biznesi, turne dhe pushime;
- Sherbime per udhetime ajrore, detare e tokesore, rezervime dhe pergatitje biletash.
- Sherbime rezervimi per hotele brenda e jashte vendit.
- Sherbime transporti brenda vendit, taksi, mikrobus, autobus
- Organizim takime e konferenca bisnesi e shoqatash.
- Sherbim informacioni, konsulence ne lidhje me udhetimin, akomodimin, transportin, kurset e kembimit te monedhave, biznesit dhe administrimit etj.

2- Te gjitha operacionet industriale, tregtare, financiare, civile, mobiliare apo imobiliare, qe kane lidhje direkte ose indirekte me objektin social si dhe me objekte te ngjashme apo te lidhura me to, qe nuk ndalohen nga legjislacioni shqiptar.

Eshte e drejte dhe si e tille duhet pranuar.

PER KETO ARESYE

Ne baze te ligjit Nr.7667 date 28.01.1993 dhe te Ligjit Nr.7638, date 19.11.1992:

# VENDOSA

Regjistrimin si person juridik te shoqerise tregetare **"UNION Travel Co."** sh.p.k, me Pese ortake, kerkuesit, **Niko Leka, Edmond Leka, Koço Bode, Gezim Hajdini** dhe **Genc Çano,** me administrator z.**Gezim Hajdini**, me kapital fillestar 25,000 USD, me kohezgjatje mbi 10 vjet, me seli ne Tirane, Rr.Muhamet Gjollesha, P.29/89, me objekt te veprimtarise ne fushen e:

1- Agjensi udhetimi turistike, per udhetime tokesore, ajrore dhe detare.
- Organizimin e udhetimeve per qellime biznesi, turne dhe pushime;
- Sherbime per udhetime ajrore, detare e tokesore, rezervime dhe pergatitje biletash.
- Sherbime rezervimi per hotele brenda e jashte vendit.
- Sherbime transporti brenda vendit, taksi, mikrobus, autobus
- Organizim takime e konferenca bisnesi e shoqatash.
- Sherbim informacioni, konsulence ne lidhje me udhetimin, akomodimin, transportin, kurset e kembimit te monedhave, biznesit dhe administrimit etj.

2- Te gjitha operacionet industriale, tregtare, financiare, civile, mobiliare apo imobiliare, qe kane lidhje direkte ose indirekte me objektin social si dhe me objekte te ngjashme apo te lidhura me to, qe nuk ndalohen nga legjislacioni shqiptar.

Kunder Vendimit lejohet ankim.

GJYQTARE
/ Gjinuca Capo /

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE
Nr.20201/1 Vendimit

# VENDIM

## I GJYQTARIT TE VETEM

Sot ne Tirane, sot me date 26-05-1999 une Gjyqtare e Gjykates se Rrethit Tirane ____________, mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga Gezim HAJDINI, Administrator i Shoqerise "UNION Travel Co." Shpk., i cili kerkon depozitimin ne Regjistrin Tregtar te Vendimit te Asamblese se Jashtzakonshme te Ortakeve te shoqerise:

### KONSTATOVA

Se me Vendim Nr.20201 date 28/10/1998 te Gjykates se Rrethit Tirane eshte regjistruar si person juridik Shoqeria me Pergjegjesi te Kufizuar UNION Travel Co., fillimisht me pese ortake, me seli ne Tirane, me kapital 25.000 USD, me objekt ne fushen:

1- Agjensi udhetimi turistike, per udhetime tokesore, ajrore dhe detare.
- Organizimin e udhetimeve per qellime biznesi, turne dhe pushime;
- Sherbime per udhetime ajrore, detare e tokesore, rezervime dhe pergatitje biletash.
- Sherbime rezervimi per hotele brenda e jashte vendit.
- Sherbime transporti brenda vendit, taksi, mikrobus, autobus
- Organizim takime e konferenca bisnesi e shoqatash.
- Sherbim informacioni, konsulence ne lidhje me udhetimin, akomodimin, transportin, kurset e kembimit te monedhave, biznesit dhe administrimit etj.

2- Te gjitha operacionet industriale, tregtare, financiare, civile, mobiliare apo imobiliare, qe kane lidhje direkte ose indirekte me objektin social si dhe me objekte te ngjashme apo te lidhura me to, qe nuk ndalohen nga legjislacioni shqiptar.

Me Vendim Nr.1 date 10/11/1999 te Asamblese se Jashtzakonshme te Ortakeve te Shoqerise eshte vendosur sa vijon:

1. Selia e shoqerise do te jete ne adresen Rr.Mine Peza Nr.2 ne Tirane.
2. Pranohen kerkesat e z.Niko Leka, z.Edmond Leka dhe z.Koço Bode per shitjen e pjeseve te kapitalit.
3. Pranohet blerja e pjeseve te kapitalit nga ortaku i ri Shoqeria Unioni Financiar i Tiranes Shpk.
4. Pranohet Shoqeria Unioni Financiar i Tiranes Shpk, si ortak i ri i shoqerise Union Travel Co.Shpk.

Kerkesa qe keto ndryshime te reflektohen ne skeden perkatese te kesaj Shoqerie, eshte e drejte dhe si e tille duhet pranuar.

### PER KETO ARESYE

Ne baze te ligjit Nr.7667 date 28.01.1993, Per Regjistrin Tregtar e formalitetet qe duhen plotesuar ne te:

# VENDOSA

Pranimin e kerkeses se z.**Gezim Hajdini**, Administrator i Shoqerise "UNION Travel Co." Shpk per depozitimin ne Regjistrin Tregtar, te Vendimit te Asamblese se Jashtzakonshme te Ortakeve te shoqerise me Nr.1 Date 03/05/1999, ku eshte vendosur:

1. Selia e shoqerise do te jete ne adresen Rr.Mine Peza Nr.2 ne Tirane.
2. Pranohen kerkesat e z.Niko Leka, z.Edmond Leka dhe z.Koço Bode per shitjen e pjeseve te kapitalit.
3. Pranohet blerja e pjeseve te kapitalit nga ortaku i ri Shoqeria Unioni Financiar i Tiranes Shpk.
4. Pranohet Shoqeria Unioni Financiar i Tiranes Shpk, si ortak i ri i shoqerise Union Travel Co.Shpk.

Mbas ketyre ndryshimeve Shoqeria "UNION Travel Co." Shpk do te jete shoqeri me tre ortake, me kapital 25.000 USD, me seli ne Tirane, Rr.Mine Peza Nr.2, me kohezgjatje mbi 10 vjet. Kapitali i Shoqerise Union Travel Co. Shpk. do te jete i ndare si vijon:

| Nr. | Emri | Shuma USD | Pjeset e kapitalit ne % | Numri rendor i pjeseve |
|---|---|---|---|---|
| 1 | **Unioni Financiar i Tiranes Shpk.** | 20.000 | 80 % | 1 - 400 |
| 2 | **Gezim Hajdini** | 3.750 | 15 % | 401- 475 |
| 3 | **Genc Çano** | 1.250 | 5 % | 476 - 500 |
| | ***TOTALI*** | ***25.000*** | ***100 %*** | ***500*** |

Urdherimin te behen ndryshimet perkatese ne skeden e kesaj shoqerie ne kolonen perkatese te regjistrit tregtar si dhe te ndahen regjistrimet nga njeri tjetri me vije te kuqe.

GJYQTARE

/ Mariana Jeqi /

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE
Nr. Rep. 20201/2

**VENDIM I GJYQTARIT TE VETEM**

Sot ne date 8/3/2002, une Gjyqtare G Kurtxhi, morra ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga Z.Gezim HAJDINI,Administrator I Shoqerise"UNION Travel Co"Shpk me objekt: Depozitimin ne Regjistrin Tregetar te Vendimit te Asamblese te jashtezakonshme te ortakeve te shoqerise dt.24.11.2001,per ndryshimin e ortakut te vjeter UFT shpk me ortakun e ri UNION GRUP shpk,kerkese qe bazohet ne nenin 21 te ligjes nr.7632 dt.4.11.1992 "Per dispozitat qe regullojne pjesen e pare te Kodit Tregetar.

Pasi u njoha me aktet e paraqitura:

**KONSTATOVA**

Shoqeria "UNION Trevel Co" shpk eshte regjistruar ne Regjistrin Tregetar me vendimin gjyqesor nr.20201dt.28.10.1998 te Gjykates te Rrethit Tirane,ndryshuar me vendimin nr.20201/1dt.26.06.2000 ku nje prej ortakeve te kesaj shoqerie ka qene edhe Unioni Financiar Tirane(UFT) shpk.

Me vendimin 01/11 dt.23/11/2001 te Asamblese se ortakeve te kesaj shoqerie eshte lejuar shitja e aseteve te UFT shpk ne formen e pjesemarjeve ne shoqerite IDA sha,UNION TREVEL shpk dhe AND shpk tek shoqeria UNION GRUP shpk. dhe njekohesisht eshte mandatuar administratori I shoqerise UFT z.Niko Leka te kryeje veprimet e nevojshme juridike prane Zyres Noteriale dhe Regjistrit Tregetar prane Gjykates te faktit Tirane.

Po ashtu me vendimin e asamblese te ortakeve te dates 23/11/2001 shoqeria UNION GRUP shpk ka pranuar oferten per blerjen e aseteve te shoqerise UFT tek shoqerite IDA sha,UNION TREVEL shpk dhe AND shpk dhe ka mandatuar administratorin e saj z.Eduard Shima te kryeje veprimet noteriale dhe ato prane Regjistrit tregetar te Gjykates te faktit Tirane.

Po ashtu per ortakun qe mungonte z.Gjergji Misha eshte mare pelqimi I tij per gjithe transaksionin e kryer me Deklaraten e tij te dates 19/12/2001

Me kontraten e shitblerjes noteriale nr3504Rep. dhe nr.442 Kol. te dates 22.12.2001 UFT shpk ja ka shitur kuoten(asetet) qe ka ne kjo shoqeri ,prej 80% te kapitalit,shoqerise UNION GRUP shpk,duke mare paraprakisht edhe pelqimin e asamblese te ortakeve te Shoqerise"UNION Treve Co" shpk,sic rezulton nga vendimi I kesaj asambleje I dates 24.11.2001

Ne keto rethana kerkuesi ,administratori I shoqerise"ADN"shpk kerkon qe ky vendim I asamblese te ortakeve te pasqyrohet ne Regjistrin Tregetar duke u bere aty ndryshimet perkatese,te hiqet ortaku I vjeter UFT shpk dhe te zvendesohet me ortakun e ri UNION GRUP shpk.

**PER KETO ARESYE**

Mbeshtetur ne nenin 21 te ligjes nr.7632 dt.4.11.1992

**V E N D O S A**

Pranimin e kerkeses te z.Gezim HAJDINI,administrator I shoqerise "UNION Trevel Co" shpk.per depozitimin ne Regjistrin Tregetar te Vendimit te Asamblese te Jashtezakonshme te ortakeve te shoqerise dt.24.11.2001 per ndryshimin e ortakut te meparshem UFT shpk me ortakun e tanishem UNION GRUP shpk,ne shoqerine UNION Trevel Co shpk

Te behen ndryshimet perkatese ne kollonat e Regjistrit Tregetar.

Te behet ndarja me vije te kuqe e ndryshimeve te bera.

Kunder ketij vendimi behet ankim ne Gjykaten e Apelit. .

**GJYQTARE**

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E FAKTIT TIRANE
Nr. Vendimi .
20201/3

**VENDIM I GJYQTARIT TE VETEM**

Sot ne date 28 /12/2004,une Gjyqtare B. Cuuu ,e Gjykates te shkalles te pare Tirane,morra ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga Z.Gezim Hajdini,Administrator I Shoqerise"UNION Travel Co"Shpk me objekt: Depozitimin ne Regjistrin Tregetar te Kontrates te shitjes nr.4589 Rep dhe nr.1607 Kol,dt.20/12/2004,sipas te ciles z.Genc CANO zoterues I 25 pjeseve me nje vlere prej 1250 USD qe perfaqesojne 5 % te kapitalit themeltar te kesaj shoqerie ja shet keto pjese me po kete vlere shoqerise "UNION GRUP" shpk. po ortake e kesaj shoqerie.

Pasi u njoha me aktet e paraqitura:

**KONSTATOVA**

Shoqeria "UNION Travel Co" shpk eshte regjistruar ne Regjistrin Tregetar me vendimin gjyqesor nr.20201 dt 28/10/1998 te Gjykates te Shkalles te pare Tirane,dhe ka per ortake Shoqerine "UNION GRUP" shpk ,zoteruese te 400 pjeseve,ne nje vlere 20.000 USD qe perfaqesojne 80 % te kapitalit themeltar; z. GezimHAJDINI, qe zoteron 75 pjese ne nje vlere prej 3750 USD qe perfaqesojne 15 % te kapitalit themeltar si dhe z. Genc CANO zoterues I 25 pjeseve, ne nje vlere 1250 USD qe perfaqesojne 5 % te kapitalit themeltar.
Me kontraten noteriale te Shitjes nr.4589 Rep dhe nr.1607 Kol,dt.20/12/2004 ortaku Genc CANO ja shet 25 pjeset e veta qe zoteron tek shoqeria "UNION Travel Co"shpk shoqerise " UNION GRUP" shpk,qe pas ketij transaksioni behet ortaku qe zoteron 425 pjese, me nje vlere 21.250 USD qe perfaqesojne 85 % te kapitalit themeltar te shoqerise.
Kontrata e sipercituar eshte firmosur nga ortaku Genc CANO dhe nga I mandatuari I shoqerise "UNION GRUP" shpk,pasi eshte dhene paraprakisht pelqimi nga asambleja e ortakeve te kesaj shoqerie

Ne keto rethana kerkuesi ,administratori I shoqerise"UNION Travel Co"shpk kerkon qe ky transaksion te pasqyrohet ne Regjistrin Tregetar duke u bere aty ndryshimet perkatese,te hiqet ortaku Genc CANO dhe te pasqyrohet ndryshimi I pjeseve te ortakut "UNION GRUP" shpk.

**PER KETO ARESYE**

Mbeshtetur ne nenin 21 te ligjes nr.7632 dt.4.11.1992

**V E N D O S A**

Pranimin e kerkeses te z.Gezim Hajdini,administrator I shoqerise "UNION Travel Co" shpk.per depozitimin ne Regjistrin Tregetar te Kontrates te Shitjes nr.4589 Rep dhe nr.1607 Kol. dt.20/12/2004, transaksion pas te cilit shoqeria "UNION Travel Co" shpk do te kete kete perberje:

| Nr | Emri | Shuma USD | Pjeset e kapitalit ne % | Numuri rendor I pjeseve |
|---|---|---|---|---|
| 1 | UNION GRUP shpk | 21.250 | 85% | 1- 425 |
| 2 | Gezim Hajdini | 3.750 | 15 % | 426- 500 |
| | | | | |
| | T O T A L I | 25.000 | 100 % | 500 |

Te behen ndryshimet perkatese ne kollonat e Regjistrit Tregetar.
Te behet ndarja me vije te kuqe e ndryshimeve te bera.

Kunder ketij vendimi behet ankim ne Gjykaten e Apelit. .

**GJYQTARE**

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**GJYKATA E SHKALLES SE PARE**
**Nr** 20201/4 **vendimit**

**V E N D I M**
**I GJYQTARIT TE VETEM**

Sot me daten 19/07/2005 Une Gjyqtare e Gjykates se Shkalles Pare Tirane [signature] pasi shqyrtova dokumentet e paraqitura nga shoqeria me pergjegjesi te kufizuar **"UNION TRAVEL CO " shpk** me Administrator te Pergjithshem:

**Z.Gezim Hajdini** me banim ne Tirane ,madhor, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, per depozitimin e dokumentave per ndryshime ne shoqeri,

***V E R E J :***

Me vendim te Gjykates se Rrethit Tirane nr.20201 dt.28.10.1998 eshte themeluar shoqeria **"UNION TRAVEL CO" shpk** me objekt te percaktuar me hollesisht ne vendimin e saj.
Duke u mbeshtetur ne Ligjin 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" ortaket e shoqerise me vendimin nr.12 date 25.5.2005 kane vendosur:
**1-Fillimin e procedurave per rritjen e kapitalit te shoqerise.**
**2-Caktimin e ekspertit Kontabel Z.Bujar Bendo per hartimin e raportit te zmadhimit te kapitalit te shoqerise.**

*Depozitimin e kerkeses prane Gjykates se shkalles se pare Tirane.
Nga dokumentet e paraqitura rezulton se kerkesa eshte e drejte dhe e bazuar ne Ligj dhe si e tille te pranohet.

**PER KETO ARSYE**
**Ne mbeshtetje te Ligjit Nr.7667 date 28 janar 1993 dhe Ligjit Nr.7638 dt.19.11.1992**

**V E N D O S A**
*Pranimin e kerkeses.
*Depozitimin e kerkeses,vendimit te asamblese se ortakeve dt.25.5.2005,licensen e ekspertit kontabel te paraqitura nga shoqeria **"UNION TRAVEL CO"** shpk duke u bere shenimet perkatese ne fleten e regjistrit ne kollonen 4 e kollona 5, te ndahen regjistrimet nga njeri tjetri me vije te kuqe.

**G J Y Q T A R E**
[signature]

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**GJYKATA E SHKALLES SE PARE**
**Nr** 20201/5 **vendimit**

# V E N D I M
## I GJYQTARIT TE VETEM

Sot me daten 06/09/2005 Une Gjyqtare e Gjykates se Shkalles Pare Tirane M. Keci pasi shqyrtova dokumentet e paraqitura nga shoqeria me pergjegjesi te kufizuar **"UNION TRAVEL CO" shpk** me Administrator Te Pergjithshem:

**Z.Gezim Hajdini** madhor, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, per depozitimin e dokumentave te shoqerise,

***V E R E J :***

Me vendim te Gjykates se Rrethit Tirane nr.20201 date 28.10.1998 eshte themeluar shoqeria **"UNION TRAVEL CO" shpk** me objekt te percaktuar me hollesisht ne vendimin e saj.
Me vendimin nr.20201/4 date 19.7.2005 eshte vendosur:"Zmadhimi i kapitalit te shoqerise.Caktimi i ekspertit kontabel Z.Bujar Bendo per hartimin e raportit te zmadhimit te kapitalit te shoqerise".
Duke u mbeshtetur ne Ligjin 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" ortaket e shoqerise me vendimin Nr.5 date 29.8.2005 kane vendosur:
**1Miratimin e raportit te ekspertit per vleresimin e kapitalit.**
**2-Miratimi I shteses se kapitalit ne vleren 6.497.559 leke duke arritur ne kete menyre kapitali I shoqerise ne shumen 10.000.000 leke.**
*Depozitimin e kerkeses prane Gjykates se shkalles se pare Tirane.
Nga dokumentet e paraqitura rezulton se kerkesa eshte e drejte dhe e bazuar ne Ligj dhe si e tille te pranohet.

**PER KETO ARSYE**

**Ne mbeshtetje te Ligjit Nr.7667 date 28 janar 1993 dhe Ligjit Nr.7638 dt.19.11.1992**

**V E N D O S A**

*Pranimin e kerkeses.
*Depozitimin e kerkeses,vendimit te asamblese se ortakeve Nr.5 dt.29.8.2005,raportit se ekspertit kontabel te paraqitura nga shoqeria **"UNION TRAVEL CO "** shpk duke u bere shenimet perkatese ne fleten e regjistrit ne kollonen 4 e kollona 5, te ndahen regjistrimet nga njeri tjetri me vije te kuqe.

**G J Y Q T A R E**
Mimoza Keci

# AKT THEMELUES
## KONTRATE

### I SHOQERISE TREGETARE PRIVATE " UNION Travel Co." SH.P.K.

1. **Niko Leka**, i biri Vlashit, datlindja 1961, lindur e banues ne Tirane, Rr.M.Gjollesha, P.29 Ap.89.
2. **Edmond Leka**, i biri Vlashit, datlindja 1963, lindur e banues ne Tirane, Rr.Lidhja Prizrenit, P.12 Shk.1/10.
3. **Koço Bode**, i biri Vangjushit, datlindja 1961, lindur ne Korçe e banues ne Tirane, Rr.Budi, Pallati Pedagogeve.
4. **Gezim Hajdini**, i biri Sabriut, datlindja 1953, lindur e banues ne Tirane, Rr.Mine Peza P.139/3 Shk.2/4.
5. **Genc Çano**, i biri Naxhi, datlindja 1963, lindur e banues ne Tirane, Rr.Gjike Kuqali, P.4, Shk.3/33.

Mbeshtetur ne nenin 251, shkronja "c", te Ligjit Nr.7512 date 10.08.1991 "Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private, nismes se lire te veprimtarise private dhe privatizimit", krijojme shoqerine tregetare private me pergjegjesi te kufizuar te quajtur **"UNION Travel Co."** dhe lidhim kete kontrate si vijon:

## FORMIMI

Neni 1

Formohet shoqeria tregetare private e quajtur **"UNION Travel Co."** sh.p.k.

Shoqeria do ti nenshtrohet legjislacionit shqiptar, ndersa deget qe mund te krijohen do ti nenshtrohen legjislacionit ku do te kete seline dega. Shoqeria do te ushtroje veprimtarine e saj ne baze te ketij akti themelues (kontrate) dhe statutit te shoqerise qe do te miratohet nga ortaket themelues.

## SELIA E SHOQERISE

Neni 2

Selia e shoqerise tregtare private **"UNION Travel Co."** sh.p.k. do te jete ne Rr.Muhamet Gjollesha, P.29/89.

Shoqeria do te hape edhe vend-qendrime te tjera te dyta, dege, filiale, perfaqesi dhe agjensi, ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise dhe me miratim te organeve kopetente edhe jashte vendit.

## OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Neni 3

Shoqeria do te zhvilloje veprimtarine e saj ne fushen e:

1- Agjensi udhetimi turistike, per udhetime tokesore, ajrore dhe detare.
- Organizimin e udhetimeve per qellime biznesi, turne dhe pushime;
- Sherbime per udhetime ajrore, detare e tokesore, rezervime dhe pergatitje biletash.
- Sherbime rezervimi per hotele brenda e jashte vendit.
- Sherbime transporti brenda vendit, taksi, mikrobus, autobus
- Organizim takime e konferenca bisnesi e shoqatash.
- Sherbim informacioni, konsulence ne lidhje me udhetimin, akomodimin, transportin, kurset e kembimit te monedhave, biznesit dhe administrimit etj.

2- Te gjitha operacionet industriale, tregtare, financiare, civile, mobiliare apo imobiliare, qe kane lidhje direkte ose indirekte me objektin social si dhe me objekte te ngjashme apo te lidhura me to, qe nuk ndalohen nga legjislacioni shqiptar.

Neni 4

Per kryerjen e veprimtarise se saj, shoqeria do te hape njesi tregtimi, sherbimi dhe perpunimi dhe do te bashkepunoje me persona fizike dhe juridike, vendas dhe te huaj.

## KOHEZGJATJA E SHOQERISE

Neni 5

Kohezgjatja e shoqerise do te jete me nje afat te pacaktuar dhe mbi 10 vjet. Ajo mund te shperbehet ne çdo kohe dhe per çfaredo lloj shkaku.

## KAPITALI I SHOQERISE

Neni 6

Kapitali fillestar i shoqerise trtegetare private **"UNION Travel Co."** sh.p.k. do te jete 25,000 USD dhe do te perbehet nga kontributet e ortakeve themelues te shoqerise. Kapitali themeltar i fiksuar ne 25.000 USD ndahet ne 500 **pjese** te barabarta me vlefte prej 50 USD secila. Ato ndahen midis ortakeve si vijon:

| NR | Emri | Shuma USD | Pjeset e kapitalit ne % | Numri rendor I pjeseve |
|---|---|---|---|---|
| 1 | **Edmond Leka** | 7.500 | 30 | 1-150 |
| | **Niko Leka** | 7.500 | 30 | 151-300 |
| | **Koço Bode** | 5.000 | 20 | 301-400 |
| | **Gezim Hajdini** | 3.750 | 15 | 401-475 |
| | **Genc Çano** | 1.250 | 5 | 476-500 |
| | ***TOTALI*** | ***25.000*** | ***100*** | ***500*** |

Kapitali fillestar mund te shtohet ose te pakesohet sipas vendimit te Asamblese se ortakeve.
Kontributet e pjesemarresve ne kapital jane te gjitha te emeruara dhe te pandashme.
Kapitali eshte teresisht i shlyeshem dhe i nenshkrueshem.

Neni 7

Ortaket duhet te beje perpjekje per rritjen e potencialit ekonomik te shoqerise, te ruajne sekretin e saj dhe te mos demtojne interesat e personave te tjere e te shoqerise.

## DREJTIMI I SHOQERISE

Neni 8

Z.**Gezim Hajdini** caktohet nga ortaket themelues te shoqerise si administrator i pare i shoqerise. Administratori ka te drejte te administroje pasurine e shoqerise dhe te kryeje te gjitha veprimet bankare qe kane te bejne me llogarine e shoqerise gjate veprimtarise se saj.

Ortaket e shoqerise kane te drejta e detyrime qe variojne ne varesi te kontributeve te kapitalit ndaj shoqerise dhe ligjeve.

Neni 9

Te ardhurat neto te shoqerise i takojne ortakeve themelues te shoqerise, ne proporcion me pronesine e tyre ne kapitalin fillestar.

Neni 10

Ortaket mund te emerojne edhe administratore te tjere te vlerave materiale te shoqerise.

Ata kane te drejte te caktojne financier, likuidator per problemet e shoqerise, si edhe te pajtojne persona te tjere si ortake. Financieri nxjerr rregullisht treguesit financiare tre-mujore, 6-mujore e vjetore, per aktivitetin e kryer te shoqerise.

Neni 11

Konfliktet qe mund te lindin midis paleve do te gjykohen ne Gjykaten e Rrethit Tirane, sipas statutit te shoqerise, kontrates se lidhur me palet dhe ne zbatim te legjislacionit shqiptar.

Neni 12

Shoqeria ka vulen e saj ne madhesi te zakoneshme, me tekstin per rrethin e saj.

Neni 13

Shoqeria deklarohet e krijuar ne zbatim te plote te normave te statutit dhe ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe veçanerisht te Ligjit Nr.7638 date 19.11.1992, "Mbi krijimin e shoqerive tregetare".

Neni 14

Ky akt themelimi (kontrate) do te hyje ne fuqi pas marrjes se lejes nga organet kopetente.

Neni 15

Akti i themelimit (kontrata), u perpilua ne disa kopje per t'iu shperndare organeve kopetente dhe nje kopje do te mbetet ne dokumentacionin baze te shoqerise tregetare private **"UNION Travel Co."** sh.p.k.

Akti i themelimit (kontrata) nenshkruhet rregullisht nga ortaket themelues.

ORTAKET THEMELUES TE SHOQERISE

**"UNION Travel Co."** sh.p.k.

**Niko Leka** **Edmond Leka** **Koço Bode** **Gezim Hajdini** **Genc Çano**

# STATUT

## I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "UNION Travel Co."

Ne baze te ligjit 7512 date 10.08.1991 "Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private, nismes se lire te veprimtarise private dhe privatizimit" dhe te ligjit Nr.7638 date 19.11.1992, "Per shoqerite tregetare", me vullnetin tone te lire, te shprehur ne nenshkrimin e Aktit Themelues (kontrates), ortaket:

1. **Niko Leka**, i biri Vlashit, datlindja 1961, lindur e banues ne Tirane, Rr.M.Gjollesha, P.29 Ap.89.
2. **Edmond Leka**, i biri Vlashit, datlindja 1963, lindur e banues ne Tirane, Rr.Lidhja Prizrenit, P.12, Ap.1/10.
3. **Koço Bode**, i biri Vangjushit, datlindja 1961, lindur ne Korçe e banues ne Tirane, Rr.Budi, Pallati Pedagogeve.
4. **Gezim Hajdini**, i biri Sabriut, datlindja 1953, lindur e banues ne Tirane, Rr.Mine Peza P.139/3 Shk.2/4.
5. **Genc Çano**, i biri Naxhi, datlindja 1963, lindur e banues ne Tirane, Rr.Gjike Kuqali, P.4, Shk.3/33.

Hartojne Statutin e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar dhe e aprovojne si me poshte:

## EMERTIMI, SELIA, KOHEZGJATJA, OBJEKTI

Neni 1

Shoqeria do te emertohet **"UNION Travel Co."** sh.p.k.

Ne te gjitha aktet e dokumentat e nxjerra nga shoqeria, emertimi duhet te paraprihet ose te pasohet nga fjalet "shoqeri me pergjegjesi te kufizuar" apo nga inicialet "SH.P.K." dhe nga shuma e kapitalit themeltar.

Neni 2

Selia e shoqerise tregtare private **"UNION Travel Co."** sh.p.k. do te jete ne Tirane, Rr.Muhamet Gjollesha, P.29/89.

Ajo mund te zhvendoset brenda rrethit me nje vendim te thjeshte te drejtuesve i cili duhet te miratohet nga Asambleja e Pergjithshme e Zakonshme, dhe ne çdo vend tjeter, me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Jashtezakonshme.

Neni 3

Kohezgjatja e shoqerise eshte e papercaktuar dhe mbi 10 vjet. Shoqeria e fiton personalitetin e vet nga momenti i regjistrimit ne regjistrin tregetar, prane Gjykates se Rrethit Tirane.

Neni 4

Shoqeria do te zhvilloje veprimtarine e saj ne fushen e:

1- Agjensi udhetimi turistike, per udhetime tokesore, ajrore dhe detare.
- Organizimin e udhetimeve per qellime biznesi, turne dhe pushime;
- Sherbime per udhetime ajrore, detare e tokesore, rezervime dhe pergatitje biletash.
- Sherbime rezervimi per hotele brenda e jashte vendit.
- Sherbime transporti brenda vendit, taksi, mikrobus, autobus
- Organizim takime e konferenca bisnesi e shoqatash.
- Sherbim informacioni, konsulence ne lidhje me udhetimin, akomodimin, transportin, kurset e kembimit te monedhave, biznesit dhe administrimit etj.

2- Te gjitha operacionet industriale, tregtare, financiare, civile, mobiliare apo imobiliare, qe kane lidhje direkte ose indirekte me objektin social si dhe me objekte te ngjashme apo te lidhura me to, qe nuk ndalohen nga legjislacioni shqiptar.

## KAPITALI I SHOQERISE

NENI 5

Kapitali themeltar i shoqerise tregetare private **"UNION Travel Co."** sh.p.k. do te jete 25,000 USD, dhe perbehet nga kontributetet e ortakeve themelues te shoqerise. Ai ndahet ne 500 pjese te kapitalit themeltar prej 50 USD secila, te gjitha te nenshkruara dhe te paguara teresisht.

Kontributet e ortakeve te shoqerise ne kapitalin fillestar jane ne proporcion si vijon dhe pjeset e kapitalit themeltar ndahen si me poshte:

| NR | Emri | Shuma USD | Pjeset e kapitalit ne % | Numri rendor i pjeseve |
|---|---|---|---|---|
| 1 | **Edmond Leka** | 7.500 | 30 | 1-150 |
| 2 | **Niko Leka** | 7.500 | 30 | 151-300 |
| 3 | **Koço Bode** | 5.000 | 20 | 301-400 |
| 4 | **Gezim Hajdini** | 3.750 | 15 | 401-475 |
| 5 | **Genc Çano** | 1.250 | 5 | 476-500 |
| | ***TOTALI*** | ***25.000*** | ***100*** | ***500*** |

Kapitali fillestar i shoqerise mund te ndryshohet sipas vendimit te ortakeve te shoqerise me vendim te asamblese se jashtezakonshme te tyre.

Kontributet e pjesemarresve ne kapital jane te gjitha te emeruara dhe te pandashme.

Kapitali eshte teresisht i shlyeshem dhe i nenshkrueshem.

Neni 6

Kapitali i shoqerise perbehet nga kapitali fillestar, mjetet e xhiros, pasuri te lujteshme ose te palujteshme etj, te nevojeshme per ushtrimin e aktivitetit te shoqerise.

Neni 7

Kuotat e kapitalit fillestar jane te derdhura nga çdo ortak ne Banke, ne llogarine bankare te shoqerise, si edhe te regjistruara ne librin e llogarise te shoqerise.

Neni 8

Heqja dore e ortakut nga bashkepunimi nuk e çliron ortakun e larguar nga detyrimet qe kane lindur para se ai te largohet. Po keshtu ai fiton edhe te drejtat qe jane krijuar para largimit te tij.

Neni 9

Shoqeria tregetare **"UNION Travel Co."** sh.p.k. eshte perdoruese dhe disponuese e pasurise se saj. Ajo mund te bleje e te shfrytezoje te drejta te tjera, materiale ose jo-materiale, duke perfshire edhe te drejten per shitjen e pasurise se vet tek te tjeret.

Ne Republiken e Shqiperise Shoqeria tregetare **"UNION Travel Co."** sh.p.k. gezon te drejta, sikunder çdo person tjeter juridik, shqiptar ose i huaj, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

Neni 10

Shoqeria tregetare **"UNION Travel Co."** sh.p.k. vepron ne regjimin e prones private dhe merr persiper te drejta e detyrime vetem brenda kufirit te kapitalit te saj.

Ortaket themelues te shoqerise mbartin rrezikun e veprimtarise se shoqerise, vetem ne nivelin e kuotave te kapitalit te investuar ne te.

Shoqeria nuk pergjigjet per detyrimet qe ortaket kane patur para se ajo te krijohet.

Neni 11 LLOGARITE RRJEDHESE

Perveç kontributeve, ortaket mund te derdhin apo lene ne dispozicion te Shoqerise çfaredo shume qe ajo mund te kete nevoje. Per kete ata mund te vene ne dispozicion llogarite e tyre rrjedhese, veçse keto nuk duhet te figurojne asnjehere debitore.

Neni 12 NDRYSHIMET E KAPITALIT THEMELTAR

1 - Kapitali themeltar mund te zmadhohet si duke krijuar pjese te reja, ashtu edhe duke rritur vleren nominale te pjeseve ekzistuese, me ane te vendimeve kolektive te jashtezakonshme te ortakeve.

12. Kapitali themeltar mund te zvoglohet me ane te nje vendimi kolektiv te jashtezakonshem te ortakeve.

Reduktimi i kapitalit themeltar nen nje minimum ligjor nuk mund te vendoset perveçse me nje kusht pezullues per nje rritje te kapitalit te destinuar per ta shpene ate te pakten ne shumen e barabarte me kapitalin themeltar minimal te parashikuar nga ligji, perjashtuar rastit kur shoqeria transformohet ne nje shoqeri te nje forme tjeter. Perndryshe, kushdo nga te interesuarit mund te kerkoje ne rruge gjyqesore shkrirjen e Shoqerise.

Kjo shkrirje nuk deklarohet, ne se ate dite qe gjykata merr vendimin, ndodh rregullimi i çeshtjes.

Ne se zvoglimi i kapitalit çon ne shfaqjen e pjeseve jo te plota, ortaket duhet ta zgjidhin midis tyre duke e bere çeshtje personale.

Neni 13 NENSHKRIMI DHE PERFAQSIMI I PJESEVE

Pjeset e kapitalit nenshkruhen teresisht dhe livrohen plotesisht nga ortaket, qofshin keto kontribute ne natyre apo ne para. Pjeset nuk mund te perfaqsohen kurre nga letra te tregtueshme.

Pronesia mbi pjeset e kapitalit rezulton vetem nga ky statut, nga aktet e mepasme qe mund te modifikojne kapitalin themeltar dhe nga leshimet apo marrjet qe jane realizuar me rregullsi.

Grumbullimi i te gjitha pjeseve ne nje dore te vetme nuk çon ne shkrirjen e shoqerise e cila mund te vazhdoje te ekzistoje edhe me nje ortak te vetem.

Neni 14 TE DREJTAT DHE DETYRIMET E LIDHURA ME PJESET E KAPITALIT

Çdo pjese kapitali i transmeton pronarit te saj nje te drejte te barabarte ne fitimet e Shoqerise, ne pronat e aktivit dhe ne bonot e likuidimit. Ajo jep gjithashtu te drejten e nje vote ne te gjitha rastet e votimeve dhe vendimeve. Ortaket pergjigjen para te treteve vetem per shumen e kapitalit te kontribuar.

Pronesia mbi nje pjese jep automatikisht te drejten per te aderuar ne statut dhe ne te gjitha vendimet e marra nga ortaket.

Neni 15 PANDASHMERIA E PJESEVE

Pjeset e kapitalit themeltar jane te pandashme para Shoqerise. Bashkepronaret e pandashem jane te detyruar te zgjedhin njerin prej tyre t'i perfaqsoje prane Shoqerise. Ne mungese mirekuptimi, i takon me te zellshmit te caktoje ne rruge gjyqesore nje mandatar per t'i perfaqsuar.

Ne se nje ose me shume pjese jane lene ne perdorim, e drejta e votes i perket pronarit te ligjshem, perveç rastit te vendimeve lidhur me shperndarjen e rezultateve, ku kjo i rezervohet perdoruesit.

Kur nje ose me shume pjese jane lene ne perdorim, e drejta e votes i perket pronarit te ligjshem per te gjitha vendimet kolektive te jashtezakonshme dhe perdoruesit per vendimet kolektive te zakonshme.

Neni 16 LESHIMI DHE TRANSMETIMI I PJESEVE TE KAPITALIT

Çdo leshim pjesesh duhet te konstatohet me akt noterial ose me nenshkrim te thjeshte privat. Qe kjo te njihet nga Shoqeria duhet qe te pranohet prej saj ne nje akt noterial. Per tu njohur nga te tretet duhet bere depozitimi ne Regjistrin e shoqerive.

Pjeset e kapitalit jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme midis ortakeve dhe bashkshorteve, para-ardhesve apo pas-ardhesve te tyre edhe kur keta nuk jane ortake.

Ato nuk mund tu leshohen te treteve jashte Shoqerise, duke i shitur apo falas, perveçse me akordin e shumices se ortakeve qe perfaqesojne te pakten tre te katertat e pjeseve te kapitalit themeltar.

Projekti i leshimit te pjeseve i behet i njohur Shoqerise dhe ortakeve nepermjet letres se nenshkruar te dorezuar ne prani te noterit apo nje personi zyrtar, apo te nje letre rekomande me pergjigje. Brenda pesembedhjete ditesh, administratori duhet te mbledhe asamblene e ortakeve per te vendosur per projektin e leshimit te pjeseve ose te konsultoje me shkrim ortaket. Vendimi i Shoqerise, i behet i njohur leshuesit te interesuar, zyrtarisht nepermjet nje njoftimi qe verteton marrjen e tij, ose me ane te nje letre rekomande me pergjigje. Ne se Shoqeria nuk e ka bere te njohur vendimin brenda nje periudhe tre mujore nga njoftimi i fundit i parashikuar ne kete statut, leja per leshimin e pjeseve konsiderohet e akorduar.

Ne se Shoqeria refuzon lejen per leshimin e pjeseve, leshuesi, brenda pesembedhjete diteve nga marrja e njoftimit, mund t'i beje te njohur Shoqerise se heq dore nga projekti i leshimit te pjeseve, nepermjet nje njoftimi te nenshkruar, te dorezuar zyrtarisht ose kundrejt nje vertetimi per marrje njoftimi, apo te derguar me leter rekomande me pergjigje.

Kur i interesuari nuk heq dore nga leshimi, ortaket jane te detyruar qe brenda nje periudhe prej tre mujajsh nisur nga refuzimi i lejes te blejne pjeset me nje çmim fiks te percaktuar sipas ligjit. (Kodit Civil)

Shoqeria brenda afatit te siperpermendur mund te bleje gjithashtu pjeset me çmimin e percaktuar si ne kushtet e mesiperme dhe te zvogeloje kapitalin me vleren nominale te pjeseve te leshuesit. Shuma per tu paguar prodhon interesa me nje perqindje sa ajo legale.

Ne se asnje nga zgjidhjet e parashikuara nuk arrihet, deri ne mbarimin e afatit, ortaku mund te realizoje leshimin e projektuar te pjeseve, ne se ai i zoteron ato te pakten qe prej dy vjetesh ose ka marre pronesine ndaj tyre me ane trashegimie, likuidimi te pasurise se perbashket mes bashkeshortesh apo dhurate te tij (te saj), nga nje paraardhes apo pasardhes. Ortaku qe nuk ploteson asnje prej ketyre konditave mbetet pronar i ketyre pjeseve.

Cilesia e ortakut i njihet bashkeshortit me pronesi te perbashket per gjysmen e pjeseve te nenshkruara apo te blera me fondet e perbashketa ne se ai i ben te ditur Shoqerise qellimin e tij per te qene ortak personalisht.

Kur venja ne dijeni kryhet ne momentin e sjelljes se kontributeve apo te blerjes, akordi i ortakeve vlen per te dy bashkeshortet. Ne se bashkeshorti(ja) ushtron te drejten e rivendikimit pas realizimit te nenshkrimit apo te blerjes, ajo do t'i nenshtrohet akordit te shumices se ortakeve qe perfaqsojne minimumi tre te katertat e kapitalit. Bashkeshorti i antarsuar do te perjashtohet nga vota dhe pjeset e tij nuk do te merren parasysh ne llogaritjen e shumices.

Vendimi i ortakeve duhet t'i behet i ditur bashkeshortit brenda dy muajve nga kerkesa e tij; perndryshe akordi konsiderohet i dhene. Ne rast te refuzimit te akordit qe i komunikohet rregullisht, bashkeshorti ortak mbetet per totalin e pjeseve te bashkesise. Komunikimi i fakteve te lartpermendura behet me leter rekomande me pergjigje.

Pjeset jane lirisht te transferueshme ne rruge trashegimie ose ne rast te likuidimit te bashkesise se pronave midis bashkeshortesh.

Transmetimi i pjeseve te kapitalit ne rruge trashegimie apo likuidimi te bashkesise i nenshtrohet akordit te shumices se ortakeve qe perfaqesojne minimumi tre te katertat e pjeseve te kapitalit, perveç trashegimtareve qe jane ortake, ne rast transmetimi per shkak vdekje, dhe per bashkshort ortak, ne rast likuidimi bashkesie.

Per ushtrimin e te drejtave te ortakeve, trashegimtaret ose ata qe kane te drejte, i nenshtrohen apo jo akordit, duhet te justifikojne identitetin e tyre dhe cilesine e trashegimtarit prane drejtuesve apo administratoreve, te cilet mund te kerkojne paraqitjen e ekstrakteve e akteve te noterizuara qe percaktojne kete cilesi.

<u>Neni 17</u> VDEKJA, NDALIMI, FALIMENTIMI I NJE ORTAKU - ORTAKU I VETEM

Shoqeria nuk prishet ne rast vdekje, ndalimi per te drejtuar, likuidimi gjyqesor apo falimentimi personal te nje ortaku. Grumbullimi ne nje dore te vetme i te gjitha pjeseve te kapitalit te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar nuk çon ne prishjen e shoqerise.

## <u>DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I SHOQERISE</u>

<u>Neni 18</u> ORGANET DREJTUESE TE SHOQERISE

Organet drejtuese te shoqerise tregetare private "**UNION Travel Co.**" sh.p.k. do te jene:

- Asambleja e ortakeve
- Administratoret
- Eksperti i revizionimit

Fusha e veprimit, perberja dhe menyra e punes se organeve drejtuese do te rregullohen me statut. Asambleja e shoqerise perbehet nga te pese ortaket themelues.

Themeluesit e shoqerise e qeverisin ate duke u mbeshtetur ne te drejten e tyre te prones private te investuar ne kete shoqeri.

Vendimet qe merr asambleja jane te detyrueshme per ortaket e shoqerise. Asambleja thirret sa here e shohin te aresyeshme ortaket themelues te shoqerise, por detyrimisht ne Dhjetor, per te miratuar programin e veprimtarise per vitin e ardhshem dhe ne Mars, per te miratuar bilancin kontabel te vitit te meparshem.

Neni 19 VENDIMET KOLEKTIVE

Ne rast te disa ortakeve, vendimet kolektive merren, sipas drejtuesve, ne asamble ose nepermjet konsultimit me shkrim. Ato mund te rezultojne nga nje leje e dhene nga te gjithe ortaket e shprehur ne nje akt zyrtar.

Ortaket thirren ne asamble nga drejtuesit ose nga nje i mandatuar i percaktuar ne gjykate me kerkesen e ortakeve. Thirrjen e asamblese mund ta kerkojne nje ose me shume ortake qe zoterojne gjysmen e pjeseve te kapitalit, ose qe zoterojne, ne rast se ata perfaqesojne nje te katerten e ortakeve, nje te katerten e pjeseve te kapitalit. Megjithate mbledhja e asamblese eshte e detyruar ne te gjitha rastet e parashikuara nga ligji.

Thirrja behet nepermjet nje lajmerimi, te vertetuar nga nje firme per marrje njoftimi, ose me leter rekomande adresuar ortakeve te pakten pesembedhjete dite para dates se mbledhjes. Ajo permban rendin e dites se asamblese te percaktuar nga autori i thirrjes. Çdo asamble e thirrur jo rregullisht mund te anullohet. Megjithate veprimi i anullimit nuk pranohet kur te gjithe anetaret jane te pranishem ose te perfaqesuar.

Asambleja e ortakeve mblidhet ne seli ose ne çdo vend tjeter te shenuar ne thirrje. Ajo drejtohet nga drejtuesi ose nje nga drejtuesit, ose kur asnjeri nga ata nuk eshte ortak, nga ortaku i pranishem, qe pranon, kur ai zoteron ose perfaqeson numrin me te madh te pjeseve te kapitalit. Kur dy ortake zoterojne ose perfaqesojne te njetin numer te pjeseve, dhe pranojne drejtimin e asamblese, ai realizohet nga me i moshuari.

Ne rast te konsultimit me shkrim, drejtoria i adreson çdo ortaku me leter rekomande tekstin e vendimeve te propozuara, si dhe dokumentat e nevojshme per informacion ortakeve.

Ortaket kane afat pesembedhjete ditor, duke filluar nga dita e marrjes se projektit te vendimeve, per te transmetuar voten e tyre drejtorise me leter rekomande. Çdo ortak qe nuk eshte pergjigjur ne afatin e siperpermendur konsoderohet si i abstenuar.

Çdo ortak ka te drejte te marre pjese ne vendimet kolektive dhe disponon nje numer votash te barabarte me ate te pjeseve qe ai zoteron. Nje ortak mund te perfaqesohet nga bashkeshorti, perveç rastit kur Shoqeria permban vetem dy bashkeshortet. Ai mund te perfaqsohet nga nje ortak tjeter, perveç rastit kur ortaket jane vetem dy, ata mund te perfaqesohen nga nje ortak tjeter jo ortak.

Çdo vendim i asamblese se ortakeve regjistrohet ne proçes verbal, qe permban shenimet rregulluese, proçes verbal i cili hartohet e firmoset nga drejtuesi ose drejtuesit, dhe ne rast te kundert nga drejtuesi i seances.

Proçes verbalet hartohen ne nje regjister me flete te numeruara ose me flete te shkeputura gjithashtu te numeruara ne perputhje me kushtet e rregullores.

Kopjet e proçes verbaleve te asamblese vertetohen te jene konform nga njeri prej drejtuesve.

Neni 20 VENDIMET KOLEKTIVE TE ZAKONSHME

Quhen te zakonshme vendimet e ortakeve qe nuk kane lidhje me modifikimet e statutit dhe me akordin per leshimin apo transferimin e pjeseve te kapitalit, te drejtes se antaresimit apo te atribuimit.

Brenda gjashte muajve nga mbyllja e aktivitetit, ortaket mblidhen ne asamble per te marre vendim per llogarine e aktivitetit dhe per shperndarjen e rezultateve.

Vendimet e zakonshme adoptohen nga nje ose me shume ortake qe perfaqsojne me shume se gjysmen e pjeseve te kapitalit. Ne se kjo shumice nuk arrihet, vendimet merren me nje konsultim te dyte, me shumicen e votave te dhena, cilido qofte numri i votuesve.

Sidoqofte, vendimet per emerimin apo per revokimin e nje drejtuesi merren gjithmone me shumicen absolute te pjeseve te kapitalit, dhe kjo nuk perben objekt te nje konsultimi te dyte me shumice te thjeshte te votave te dhena.

Neni 21 VENDIMET KOLEKTIVE TE JASHTEZAKONSHME

Quhen te jashtezakonshme, vendimet qe kane per objekt modifikimin e statutit ose te akordojne dhenjen apo transferimin e pjeseve te kapitalit, te drejten e antarsimit dhe te atribuimit.

Vendimet e jashtezakonshme konsiderohen te vlefshme kur ato jane adoptuar nga:

- unanimisht, ne rast ndryshimi te nenshtetesise se Shoqerise, te transformimit te Shoqerise ne shoqeri kolektive, ne komandite te thjeshte, ne komandite me aksione apo ne shoqeri civile.
- me shumicen e ortakeve, qe perfaqsojne te pakten tre te katertat e pjeseve te kapitalit, te rritjes se angazhimit te nje ortaku ne rastin e pranimit te ortakeve te rinj apo te autorizimit te dorezanise se pjeseve.
- nga ortake qe perfaqsojne te pakten tre te katertat e pjeseve te kapitalit per te gjitha vendimet e tjera te jashtzakonshme.

Neni 22 E DREJTA E KOMUNIKIMIT, INFORMIMIT DHE E KONTROLLIT TE ORTAKEVE

Çdo ortak ka te drejten e nje komunikimi te vazhdueshem, shtrirja dhe menyrat e ekzekutimit te te cilit percaktohen me dispozitat e rregulloret ne fuqi.

Para çdo asambleje apo konsultimi me shkrim, ortaket kane te drejten e komunikimit te dokumentave e te informacioneve qe u drejtohen ose qe u vihen atyre ne dispozicion ne kondital e fiksuara nga dispozitat ligjore e rregulloret ne fuqi.

Çdo ortak jo drejtues mundet, dy here ne vit, te beje me shkrim pyetje drejtorise per çdo fakt qe ka te beje me komprometimin e vazhdimesise se aktivitetit. Pergjigja me shkrim e drejtorise duhet te kryhet ne nje afat prej nje muaji.

Nje ose me shume ortake qe perfaqsojne te pakten nje te dhjeten e kapitalit themeltar, individualisht apo ne grup, mund te kerkojne prane organeve te drejtesise caktimin e nje ose me shume eksperteve, te ngarkuar per paraqitjen e nje raporti mbi nje ose me shume operacione te drejtorise. Kushtet e emerimit dhe te ushtrimit te ketij misioni parashikohen me ligj dhe me rregullore.

Neni 23 ADMINISTRATORI

Shoqeria do te drejtohet nga administratori i saj. Ortaket themelues te shoqerise caktojne z.**Gezim Hajdini** si administrator te pare te saj.

Administratori ka te drejte te administroje pasurine e shoqerise dhe te kryeje te gjitha veprimet bankare qe kane te bejne me llogarine e shoqerise

Paga e tij do te fiksohet nga asambleja me e afert. Ai do te rimbursohet, kundrejt faturave justifikuese, per shpenzimet e zhvendosjes dhe te perfaqsimit.

Ne marredhenie me te tretet, kopetencat e drejtuesit apo drejtuesve jane me te gjerat per te vepruar ne çdo rrethane ne emer te Shoqerise, perveç kompetencave qe ligji ua jep ortakeve.

Shoqeria angazhohet edhe nga aktet e administratorit qe tejkalojne objektin social, me perjashtim te rastit kur ajo provon se te tretet e dinin qe akti tejkalonte kete objekt ose qe ata nuk mund ta injoronin duke pasur parasysh rrethanat, meqe thjesht publikimi i statuteve nuk mjafton si prove.

Ne raportet midis ortakeve, drejtuesi (administratori) mund te kryeje te gjitha aktet e drejtimit ne interes te Shoqerise. Megjithate, ne kuadrin e rregullores se brendshme dhe pa qene nevoja qe keto kufizime tu paraqiten te treteve, vendoset qe drejtuesi, (administratori) pa qene i autorizuar paraprakisht nga nje vendim i zakonshem i ortakeve, nuk mund te bleje, shese apo te kembeje çdo vlere te patundshme, fond tregtie, te kontraktoje borxhe per llogari te Shoqerise, perveçse zbulimeve normale ne banke, te vere ne hipoteke ndonje pasuri te patundshme apo te vere peng nje fond tregtie.

Drejtuesit jane te revokueshem me vendim te ortakeve qe perfaqsojne me shume se gjysmen e pjeseve te kapitalit.

Drejtuesit jane pergjegjes, individualisht ose solidarisht sipas rastit, kundrejt Shoqerise apo te treteve, per shkeljet e dispozitave ligjore apo rregullave te aplikuara per shoqerite me pergjegjesi te kufizuar, per shkeljet e statutit, apo per fajet e kryera gjate drejtimet te tyre.

Ne se disa drejtues jane bashke-pergjegjes per nje fakt, gjykata percakton pjesen perkatese te secilit prej tyre ne shlyerjen e demit.

Asnje vendim i Asamblese nuk mund te kete per efekt nderprerjen e nje veprimi te ndermarre ndaj pergjegjesise se drejtuesve per faje te kryera gjate permbushjes se mandatit te tyre.

Neni 24 EKSPERTI KONTABEL

Ortaket mund te caktojne nje ose me shume eksperte kontabel, me vendim te zakonshem te asamblese. Caktimi i ekspertit kontabel te shoqerise behet i detyruar kur permbushen kerkesat e Ligjit "Per Shoqerite Tregtare" Nr.7638, date 19.11.1992. Ata ushtrojne veprimtarine ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi

Neni 25 MARREVESHJET MIDIS NJE DREJTUESI APO NJE ORTAKU DHE SHOQERISE

Drejtoria i paraqet Asamblese, ose i bashkengjit dokumentave qe i komunikohen ortakeve, kur konsultimi behet me shkrim, nje raport mbi marreveshjet e nenshkruara midis Shoqerise dhe ndonje drejtuesi apo ortaku. Asambleja vendos per kete raport, i cili duhet te permbaje elementet e meposhtem:

- rendin e marreveshjeve qe i nenshtrohen aprovimit te asamblese se ortakeve;
- emrin e drejtuesve apo ortakeve te interesuar nga ato;
- natyren e objektin e marreveshjeve te lartpermendura;

modalitetet kryesore te ketyre marreveshjeve, si çmimet apo tarifat e praktikuara, te ardhurat dhe komisionet e lejuara, afatet e pagesave te akorduara, interesat e percaktuara, siguri te dhena dhe sipas rastit, te gjitha indikacionet e tjera qe lejojne ortaket te vleresojne interesin qe lidhet me perfundimin e marreveshjeve te analizuara;

- rendesia e mallrave te blera apo e sherbimeve te kryera, si dhe totalin e shumave te derdhura apo arketuara gjate ushtrimit te aktivitetit te fundit.

Drejtuesi apo ortaku i interesuar nuk mund te marrin pjese ne votim dhe pjeset e tij nuk do te merren parasysh ne llogaritjen e kuorumit dhe te shumices.

Marreveshjet e kryera nga nje drejtues jo ortak i nenshtrohen miratimit paraprak te Asamblese.

Marreveshjet e pa miratuara japin megjithate efektet e tyre, ne ngarkim te drejtuesit, dhe kur eshte rasti, per ortakun kontraktues, te cilet duhet te perballojne individualisht apo solidarisht, sipas rastit konsekuencat e kontrates se paragjykuar nga shoqeria.

Keto dispozita shtrihen edhe per marreveshjet e kaluara me nje shoqeri ku nje ortak me pergjegjesi te papercaktuar, drejtues, administrator, drejtor i pergjithshem, antar i drejtorise apo i keshillit mbikqyres, eshte njekohesisht drejtues apo ortak i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar.

Keto dispozita nuk jane te aplikueshme per marreveshjet qe kane te bejne me veprimtarine e zakonshme dhe te mbyllura ne kushte normale.

Perkundrejt çvleresimit te kontrates, i ndalohet drejtuesve apo ortakeve perveç personave morale, te kontraktojne ne çfaredo forme qe te jete, borxhe prane Shoqerise, mbulimi nga ana e saj e nje zbulimi bankar, ne llogari rrjedhese apo tjeter, si dhe garantimi ose dorezania nga ana e saj e nje angazhimi ndaj te treteve. Ky ndalim aplikohet edhe per bashkeshortet, parardhes ose pasardhes te drejtuesve apo ortakeve si dhe ndaj te gjithe personave ndermjetes dhe perfaqsuesve legale te personave morale ortake.

## Neni 26 AKTIVITETI SOCIAL - LLOGARITE SOCIALE

Çdo aktivitet ka nje kohezgjatje prej nje viti, qe fillon ne 01.01 te çdo viti dhe perfundon ne 31.12 te te njejtit vit. Si perjashtim, aktiviteti i pare fillon ne diten e regjistrimit te Shoqerise ne Regjistrin e shoqerive tregtare dhe mbaron ne 31 Dhjetor. Ne mbylljen e çdo aktiviteti vjetor, drejtoria harton nje inventar te aktivit e te pasivit te Shoqerise, si dhe llogarite vjetore (bilanc, llogari humbje-fitimi, rezultat vjetor).

Shuma e angazhimeve si garanci apo peng te Shoqerise i bashkohet aneksit te bilancit, sikurse edhe nje situacion i sigurive te leshuara prej saj.

Drejtoria harton nje raport per situaten e Shoqerise dhe aktivitetin e saj pergjate vitit te shkuar, rezultatet e ketij aktiviteti, progresin e realizuar dhe veshtiresite e hasura, parashikimin per evoluimin e situates, dhe perspektiven ne te ardhmen, evenimentet e rendesishme te ndodhura midis dates se mbylljes se aktivitetit dhe dates ne te cilen paraqitet raporti, dhe se fundi aktivitetet e lidhura me fushen e kerkim zhvillimit.

Llogarite vjetore mbahen pas çdo aktiviteti sipas te njejtave forma dhe metoda vleresimi si dhe vitet paraardhese, perveç se kur nje ndryshim i jashtezakonshem ka ndodhur ne situaten e Shoqerise.

Drejtoria vijon punen edhe ne rast mungese apo pamjaftueshmerie fitimesh apo rezervash e kuotash amortizimi te nevojshme.

Ne rast se ne mbyllje te aktivitetit, Shoqeria i pergjigjet njerit prej kritereve te percaktuara me dekret, drejtoria eshte e detyruar te hartoje nje situacion te aktivit te realizuar dhe disponibel, perjashtuar nga vlerat e shfrytezimit, dhe te pasivit te kerkuar, nje parashikim te shpenzimeve e te ardhurave, nje tabele financimesh si dhe nje bilanc vjetor e nje plan financimi parashikues, ne kushtet dhe sipas periodicitetit te parashikuar me ligj apo dekret.

Llogarite vjetore, raporti i drejtorise dhe teksti i rezolutave te propozuara i vihen ne dispozicion Ekspertit Kontabel te pakten nje muaj para thirrjes se asamblese. Po keto dokumenta, dhe sipas rastit, raporti i Ekspertit Kontabel, i adresohen ortakeve te pakten pesembedhjete dite para dates se asamblese qe thirret per tu shprehur per analizen financiare.

## Neni 27 PERCAKTIMI DHE SHPERNDARJA E FITIMEVE

Fitimi (ose humbja) i aktivitetit vjetor çfaqet ne pasqyren shpenzime-te ardhura nga diferenca e te ardhurave (produkteve) dhe shpenzimeve te aktivitetit dhe pas zbritjes se amortizimit dhe rezervave.

Nga ky fitim, i zvogluar me humbjet eventuale te meparshme, hiqen shumat per rezerve ne zbatim te ligjit, dhe veçanerisht perkundrejt anullimit te mundshem te çdo vendimi te kundert, nje shume qe i korespondon nje te njezetes per krijimin e fondit te rezerves legale. Kjo heqje (derdhje) pushon se qeni e detyruar kur fondi rezerve arrin nje te dhjeten e kapitalit themeltar.

Fitimi per tu shperndare perbehet nga fitimi i aktivitetit, zvogluar me humbjet e meparshme dhe shumat e vendosura ne rezerve ne zbatim te ligjit dhe te statutit. Ky fitim shperndahet midis te gjithe ortakeve proporcionalisht me numrin e pjeseve qe i perkasin secilit prej tyre.

Asambleja e pergjithshme mund te vendose shperndarjen e shumave te marra nga rezervat, te cilat ajo i disponon, duke treguar shprehimisht postet e rezerves mbi te cilat jane kryer keto marrje. Megjithate, dividendet shkeputen ne menyre prioritare nga fitimi i shperndarshem i aktivitetit.

Menyrat e pageses se dividendeve te votuar nga Asambleja e Pergjithshme fiksohen nga ajo vete ose perndryshe nga drejtoria. Pagimi i dividendeve duhet te kryhet brenda nje afati maksimal prej nente muajsh pas mbylljes se aktivitetit, perveç zgjatjes se afatit nga gjykata.

Asnje shperndarje nuk mund te behet kur kapitali eshte, ose do te behej pas shperndarjes, me i vogel se shuma e kapitalit e rritur me rezervat qe ligji nuk lejon te shperndahen.

Asambleja e Pergjithshme mund te vendose gjithashtu te kaloje shumat e shperndarshme ne ri-kapitalizim, totalisht apo pjeserisht.

Neni 28 KAPITALI ME I VOGEL SE GJYSMA E KAPITALIT THEMELTAR

Ne se per shkak te humbjeve te konstatuara ne dokumentat kontabel, kapitalet e Shoqerise behen me te vogla se gjysma e kapitalit themeltar, drejtoria, brenda kater muajve qe pasojne aprovimin e analizes financiare qe paraqet kete humbje, duhet te konsultoje ortaket me qellim qe te vendose, ne se ka vend per shkrirje paraprake te Shoqerise.

Ne se shkrirja nuk miratohet, kapitali, ne perputhje me dispozitat ligjore lidhur me kapitalin minimum ne shoqerite me pergjegjesi te kufizuar dhe ne afatet e percaktuara nga ligji, duhet te zvoglohet ne masen e barabarte me humbjet qe nuk mund te perballoheshin nga rezervat, ne qe nderkohe kapitali nuk eshte barazuar te pakten me gjysmen e kapitalit themeltar.

Ne te gjitha rastet, vendimi i Asamblese se pergjithshme duhet te publikohet brenda kushteve ligjore.

Ne rast te mosvezhgimit te sa parashkruhet, cilido nga te interesuarit mund te kerkoje ne organet gjyqesore shkrirjen e Shoqerise. Po keshtu edhe ne rastin kur Asambleja nuk ka marre vendim te vlefshem.

Neni 29 TRANSFORMIMI I SHOQERISE

Transformimi i Shoqerise ne nje shoqeri te nje tipi tjeter mund te vendoset nga ortaket, qe vendosin ne perputhje me kushtet e shumices se parashikuar per modifikimin e statutit. Sidoqofte transformimi i Shoqerise ne shoqeri kolektive, komandite te thjeshte, komandite me aksione apo shoqeri civile kerkon akordin unanim te ortakeve.

Transformimi ne shoqeri anonime vendoset me shumicen e kerkuar per modifikimin e statutit. Megjithate, ajo mund te vendoset nga ortaket qe perfaqsojne shumicen e pjeseve, ne se kapitali i saj arrin shumen prej njezet milion leke.

Vendimi per transformimin ne shoqeri anonime paraprihet nga nje raport i Ekspertit Kontabel te shkruar prane Shoqerise, dhe te nje raporti, te nje ose me shume ekspertesh per transformimin, te caktuar, perveç rastit te akordit unanim te ortakeve, me vendim te gjykates dhe te ngarkuar per te vleresuar, nen pergjegjesine e tyre, vleren e pasurive qe perbejne aktivin dhe avantazhet e veçanta. Ekspertet per transformim mund te ngarkohen per formulimin e nje raporti mbi situaten e Shoqerise. Ne kete rast, redaktohet vetem nje raport. Eksperti kontabel i Shoqerise mund te emerohet Ekspert per transformim.

Ortaket vendosin per vleresimin e pasurise dhe dhenien e avantazheve te veçanta; ata nuk mund t'i zvoglojne perveçse me unanimitet. Ne mungese te aprovimit te shprehur te ortakeve te permendur ne proçes-verbal, transformimi eshte i pavlefshem.

Neni 30 SHKRIRJA - LIKUIDIMI

Shperberja e shoqerise, mund te vije ne çdo kohe dhe per çfaredo shkaku, si:
- Humbja e kapitalit te shoqerise,
- Pamundesi veprimi,
- Me vendim te asamblese se ortakeve

Ne keto raste, pronaret e shoqerise vendosin mbi menyren e likuidimit dhe caktojne nje ose me shume likuidatore duke iu percaktuar edhe detyrat.

Shoqeria shkrihet ne rast te realizimit apo shuarjes se objektit te saj ose me vendim gjyqesor per arsye te drejta.

Shkrirja para afatit mund te vendoset ne çdo moment nga ortaket qe perfaqsojne tre te katertat e pjeseve te kapitalit themeltar.

Shoqeria vihet ne likuidim qe nga momenti i shkrirjes se saj per çfaredo arsye qofte.

Personi moral i Shoqerise vazhdon, per nevoja te likuidimit, deri ne perfundimin e tij. Shkrirja e Shoqerise jep efekte ndaj te treteve vetem nga data kur ajo publikohet ne Regjistrin e shoqerive tregtare. Emertimi "shoqeri ne likuidim" duhet te shenohet ne te gjitha aktet e dokumentat qe dalin nga Shoqeria.

Funksionet e drejtimit dhe drejtuesve perfundojne me shkrirjen e Shoqerise. Kolektiviteti i ortakeve ruan fuqite dhe rregullon menyren e likuidimit; ai emeron nje ose me shume likuidatore, te zgjedhur nder ose jashte ortakeve, dhe percakton fuqite e tyre. Likuidimi behet konform ligjit.

Pas rimbursimit te shumes se pjesve te kapitalit, bono e likuidimit ndahet midis ortakeve, ne perputhje me numrin e pjeseve qe i takojne secilit prej tyre.

Ne rast te bashkimit te gjithe pjeseve ne nje dore te vetme, ne se paraqitet rasti per likuidim atehere kemi vetem transmetim universal te pasurise pa pasur nevoje per likuidim.

Neni 31

Administratoret dhe likuidatori jane pergjegjes per ruajtjen e pasurise se shoqerise per derisa ajo t'u dorezohet personave perkates fizik e juridik, duke likuiduar ne rradhe te pare detyrimet ndaj personave te trete qe ka shoqeria. Ne rast se fondet disponibel, rezultojne te pamjaftueshme, per shlyerjen e detyrimeve te shoqerise, likuidatori mund t'i kerkoje ortakeve themelues te shoqerise qe te derdhin teresisht kuotat qe i'u takojne atyre respektivisht.

Neni 32 KONTESTIMET

Ne rast te me shume se nje ortaku, te gjitha kontestimet qe mund te dalin gjate ekzistences se Shoqerise apo gjate likuidimit te saj midis Shoqerise dhe ortakeve, lidhur me aktivitetin e saj apo me ekzekutimin e statutit, i paraqiten gjykates kompetente.

Te gjitha kontestimet qe mund te dalin gjate ekzistences se Shoqerise, apo gjate likuidimit te saj, qofte midis ortakeve dhe Shoqerise, qofte dhe midis vete ortakeve, per pune te aktivitetit apo ekzekutimit te statutit, do t'i nenshtrohen proçedures se arbitrazhit.

Secila prej paleve cakton nje arbiter, arbitrat e caktuar zgjedhin nje arbiter tjeter, ne menyre qe juria te perbehet nga nje numur tek antaresh. Ne mungese, gjykata qe mbulon seline e Shoqerise, e kontaktuar prej njeres nga palet apo nga nje arbiter, proçedon ne menyre urdherore (me vendim).

Instanca arbitrare nuk perfundon me revokimin, vdekjen, pengimin, abstenimin, terheqjen apo refuzimin e nje arbitri. Gjykata e kontaktuar si me lart cakton nje arbiter te ri. Ky vendim nuk rishikohet dhe nuk rishqyrtohet.

Arbitrat nuk detyrohen te ndjekin rregullat e gjykates. Ata do te vendosin si keshilltare miqesore ne formen e nje vendimi te pare joperfundimtar, perderisa palet bien dakord shprehimisht qe te mos heqin dore nga rruga e apelimit.

Palet i japin kompetenca Gjykates civile qe mbulon seline e Shoqerise, si per zbatimin e dispozitave qe paraprijne, ashtu dhe per rregullimin e çdo veshtiresie tjeter.

Neni 33 REGJISTRIMI - PUBLIKIMI - FUQITE

Shoqeria do te gezoje personin juridik duke filluar nga data e regjistrimit ne Gjykate ne Regjistrin e shoqerive tregtare. Megjithate, para nenshkrimit te statutit, jane kryer per llogari te Shoqerise ne krijim, aktet e permendura ne nje aneks te ketij statuti, dhe qe tregojne per secilin prej tyre angazhimin qe rezultonte per Shoqerine. Ky situacion depozitohet ne afatet ligjore ne seline e ardhshme, ne dispozicion te antareve te ardhshem te Shoqerise, sikurse e njohin te gjithe nenshkruesit. Ky situacion do te mbetet aneks i statutit.

I jepet mandat z. **Gezim Hajdini** te marre persiper, per llogari te Shoqerise, ne pritje te regjistrimit te saj ne Gjykate ne Regjistrin e Shoqerive Tregtare, angazhimet qe pershkruhen dhe modalitetet e te cilave pershkruhen ne nje situacion te dyte qe gjithashtu i aneksohet statutit.

Regjistrimi i Shoqerise çon ne marrjen nga ana e saj, me te drejta te plota, te angazhimeve te lartpermendura. I jepet fuqi e plote z. **Gezim Hajdini** per kryerjen e te gjitha formaliteteve te publikimit e regjistrimit lidhur me themelimin e Shoqerise dhe veçanerisht:

- per te proçeduar me te gjitha formalitetet per regjistrimin e Shoqerise ne Regjistrin e shoqerive tregtare;
- dhe pergjithesisht, mbajtesit te nje origjinali apo kopje te statutit per kryerjen e formaliteteve te parashikuara ne ligj.

DISPOZITA TE PERGJITHESHME

Neni 34

Persa nuk eshte shprehur plotesisht ne kete statut, referohen plotesimet qe do te behen nga ortaket themelues, si edhe ligjeve te veçanta te legjislacionit shqiptar. Ndryshimet e plotesimet e ketij statuti behen me menyren dhe proceduren me te cilen nxirret vete statuti.

Neni 35

Ky statut perpilohet ne disa kopje per t'iu shperndare organeve kopetente dhe nje kopje mbetet ne dokumentacionin baze te shoqerise tregetare private **"UNION Travel Co."** sh.p.k.

ORTAKET THEMELUES TE SHOQERISE

**"UNION Travel Co."** sh.p.k.

**Niko Leka** **Edmond Leka** **Koço Bode** **Gezim Hajdini** **Genc Çano**

REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERIA E TIRANES
Nr. 7322 Rep
Nr. 843 Kol

Tirane me 27/10/1998

VERTETIM

Sot me dt. 27/10/1998 u paraqit para meje zoti (zoterinjte) e sipershenuar, madhore, te njohur personalisht prej meje, per identitetin e te cileve u njoha nga leternjoftimet perkatese, te cilet deklaruan se sa me siper eshte hartuar me vullnetin e tyre te lire dhe te plote dhe nenshkruhet pa verejtje ne pranine time dhe une e vertetoj sipas ligjit.

NOTERE
LIRI GJOLIKU
TIRANE

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**SHOQERIA TREGTARE**
**"UNION TRAVEL CO" SH.P.K**

**V E N D I M**
ASAMBLESE SE ORTAKEVE
**NR 5 DATE 28.8. 2005**

Shoqeria"UNION TRAVEL CO"**sh.p.k** eshte e regjistruar si person juridik me vendimin Nr 20201 date 28.10.1998 te Gjykates se Rrethit Tirane .

Sot ne mbledhjen e dates 28.8. , Asambleja e Oratakeve te shoqerise **"UNION TRAVEL CO" sh.p.k** mori ne shqyrtim aktivitetin e shoqerise dhe ecurine e saj net e ardhmen dhe ne perputhje me statutin dhe ligjin

**V E N D O S I :**

3. Miratimin e Raportit te Ekspertit per vleresimin e kapitalit.
4. Miratimin e shteses se kapitalit ne vleren 6.497.559 leke duke arritur ne kete menyre kapitali I shoqerise ne shumen 10.000.000 leke.
   Depozitimin e ketyre ndryshimeve ne regjistrin tregtar..

**ASAMBLEJA E ORTAKEVE**

**Gezim Hajdini**

**"Union Group "sh.p.k**
**Administrator**
**Niko Leka**

Niko Leka

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**DHOMA E NOTERISE TIRANE**
**NR.___8871___REP**

**NR.___2305___KOL**

**VERTETIM**

Sot me date ___2.9.___2005, para meje noterit public ___N. Kolaj___, u paraqiten personalisht Gezim Hajdini dhe "Union Group "sh.p.k, e perfaqesuar nga administratori Niko Leka te identifikuar prej meje nepermjet pasapotave perkatese;madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar , me cilesine e ortakeve te shoqerise"UNION TRAVEL CO" sh.p.k,te cilet me deklaruan se dokumentin e masiperm e kane redaktuar jashte kesaj zyre me vullnetin e tyre te lire dhe e nenshkruan ate para meje.Une noteri e vertetoj ate sipas ligjit.

**N O T E R I  P U B L I K**

Noter
Mimoza
Tel.: (04) 23...

**Shoqeria Private* UNION TRAVEL CO*shpk Tirane**
**Kapitali Themeltar 3.502.441 leke**
**Administrator z Gezim Hajdini**

---

**RAPORT I VECANTE EKSPERTIT**

Per zmadhim kapitali te shoqerise ***UNION TRAVEL CO***shpk .

**Tirane**

Me vendim te mbledhjes se Asambles se Ortakeve te Shoqerise private ***UNION TRAVEL CO***sh.p.k me seli ne Tirane, e perfaqesauar nga Ortaku z **Gezim Hajdini** dhe njekohesisht administrator ,na ka caktuar si ekspert per te perpiluar raportin e vecante ne lidhje me zmadhimin e kapitalit duke u nisur nga gjendja faktike e pasurise se Shoqerisene fund te vitit 2004. Zmadhimi I kapitalit do te kete si burim fitimet e mbartura te Shoqerise deri ne fund te vitit 2004.

Une ,Bujar Bendo, me cilesine e Ekspertit Kontabel te Autorizuar ,I licensuar me nr.79 dt 12.04.2000 te Komisionit te Regjistrimit prane IEKA-s.regjistruar ne regjistrin tregtar me vendimin e gjykates nr 510 date 22.05.2000 dhe I regjistruar prane Deges se Tatim Taksave me Kod Fiskal 2301440, pranuam misionin e percaktuar nga Asambleja e Ortakeve te Shoqerise *** UNION TRAVEL CO** *shpk, me administrator z. **Gezim Hajdini** duke patur parasysh dhe nenet 168 e 169 mbi papajtueshmerine mbi emerimin e Ekspertit kontabel te Autorizuar ne baze te ligjit nr 7638 date 19.11.1992 "Per "Shoqerite Tregtare."

Me cilesine e Ekspertit Kontabelte Autorizuar per te bere kete Raport te Vecante per zmadhimin e kapitalit te shoqerise jemi mbeshtetur ne keto dokumenta :

1. Dokumenta ligjore
   - Vendim Gjykate nr 20.201 date 28.10.1998 per regjistrimin ne regjistrin tregtar te shoqerise.
   - Statut dhe Akt-themelimi te Shoqerise
   - Certifikata e regjistrimit ne organin Tatimor me kod Fiskal.
   - Numri I identifikimit te personit Tatueshem.
   - Vendimin e Asambleja e Ortakeve per emerimin si Ekspert.
2. Dokumenta Ekonomik .
   - Bilancin e fundvitit 2004.
   - Raportin e E kspertit kontabel mbi opinionin e Bilancit te vitit 2004.
   - Ne inventaret Kontabel te aktiveve dhe pasiveve te perpiluara nga shoqeria e te Rishikuara nga ana e jone mbi vleresimin e tyre.
   - Cdo document apo informacion I kerkuar nga ana e jone ne mbeshtetje te ketij Raporti.

Bilanci I rishikuar nga ana e jone eshte e paraqitur me poshte dhe perben bazen e ketij raporti. **Bilanci I ushtrimit 2004 I shoqerise * UNION TRAVEL CO*shpk me seli ne Tirane**

Duke u nisur nga dokumentat e kontrolluara dhe te vertetuara, kontabilizimet, ne pozicionin e duhur ,opinionin e Ekspertit ne lidhje me Llogarite vjetore 2004, rezulton se ne Pasiv te bilancit ,ne grupin e Kapitaleve te Veta ,fitimet e realizuara paraqiten:

1. Fitimi I mbartur ne shumen 4.649.028 leke
2. Fitimi ushtrimor 2004 ne shumen 2.744.062 leke

Totali I fitimeve 7.393.090 leke

Asambleja e Ortakeve ka vendosur qe shumen e fitimeve te realizuara nga aktiviteti deri ne fund te vitit 2004, te shperndaje divident 758.329 leke, te kaloje ne rezerva ligjore 137.202 leke dhe pjesen e mbetur ne shumen 6.497.559 leke ,te mos e kerkoje si detyrim ,por ta kaloje ne zmadhim te Kapitalit Themeltar te Shoqerise. Si rezultat I ketyre veprimeve dhe I vendimit te Ortakut te vetem ne ngjarjet ekonomoke te vitit 2004 do te kryhet ky veprim Kontabel:

Debi Llogaria 107*Fitime te Mbartura 4.649.028 leke.

Debi Llogaria 121 * Fitime te ushtrimit 1.848.531 leke

**Kredi Llogaria 101 *Kapitali I nenshkruar 6.497.559 leke**

**Ne perfundim Shoqeria * UNION TRAVEL CO *sh.p.k do te beje zmadhimin e kapitalit ne shumen 6.497.559 leke dhe ne total kapitali I shoqerise eshte :**

| | |
|---|---|
| **Kapitali I Themelimit** | **3.502.441 leke** |
| **Shtese kapitali** | **6.497.559 leke** |
| **Totali** | **10.000.000 leke** |

Zoterues I ketij kapitali prej 10.000.000 leke eshte Ortaku z **Gezim Hajdini** dhe shoqeria **" Union Group " sh.p.k**

Ky raport u behet I njohur Ortakeve te Shoqerise dhe Administratorit te saj per te kryer veprimet e duhura ne kontabilitet dhe ne regjistrin tregtar prane Gjykates.

**Tirane , me dt 28.2005.**

**Ekspert Kontabel I Autorizuar**

**z. Bujar Bendo**

EKSPERT KONTABEL AUTORIZUAR BUJAR BENDO

2020/15 3 Blerimo [illegible]

06.09.2005

06 SHTATOR 2005

# K ERKESE

**KERKUESI :** Gezim Hajdini , madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar ,me cilesine e ortakut dhe administratorit te shoqerise "UNION TRAVEL CO" sh.p.k

**OBJEKTI :** Depozitimin ne regjistrin tregtar te vendimit Nr 5 dt. 28.8.2005 Te Asamblese se Ortakeve te Shoqerise "UNION TRAVEL CO"sh.p.k

Te depozitohet

**GJYKATES SE SHKALLES SE PARE**

**TIRANE**

kerkesa dt 06.09.05

Me vendimin Nr 20201 ,date 28.10.1998 te Gjykates se Rrethit Tirane eshte regjistruar si person juridik shoqeria tregtare"UNION TRAVEL CO" sh.p.k me ortake-Gezim Hajdini dhe "Union Group "sh.p.k dhe administrator Gezim Hajdini.

Kapitali themeltar I shoqerise eshte 3.502.441 leke,I ndare 15 % te kapitalit e zoteron ortaku Gezim Hajdini ose 525.366 leke.dhe 85 % te kapitalit e zoteron ortaku "Union Group "sh.p.k ose 2.977.075 leke

Aktualisht Asambleja e Ortakeve te shoqerise"UNION TRAVEL CO" sh.p.k me vendimin Nr5 date 28.8. 2005 ka vendosur :

Vendimi i As Ortakeve Nr 5 dt 28.8.05 Raport Eksperti 28.8.05 + Bilanci i depozituar

1. Miratimin e Raportit te Ekspertit per vleresimin e kapitalit.
2. Miratimin e shteses se kapitalit ne vleren 6.497.559 leke duke arritur ne kete menyre kapitali I shoqerise ne shumen 10.000.000 leke.
   Depozitimin e ketyre ndryshimeve ne regjistrin tregtar..

Ne keto kushte kerkoj depozitimin e ketyre ndryshimeve prane regjistrit tregtar.

**K E R K U E S**

Gezim Hajdini

UNION TRAVEL Co Sh.p.k UT Co TIRANA ALBANIA

20201/4

Gj. B. Muse
18.07.2005
19 KORRIK 2005

# K E R K E S E

**KERKUESI :** **Z.Gezim Hajdini** , madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar ,me cilesine e ortakut dhe administratorit te shoqerise"UNION TRAVEL CO" sh.p.k.

**OBJEKTI :** Depozitimin ne regjistrin tregtar te vendimit Nr 12 dt.25.05.2005 te Asamblese se Ortakeve te shoqerise "UNION TRAVEL CO"sh.p.k

**GJYKATES SE SHKALLES SE PARE**

**TIRANE**

Me vendimin Nr .20201 ,date 28.10.1998 te Gjykates se Rrethit Tirane eshte regjistruar si person juridik shoqeria tregtare"UNION TRAVEL CO" sh.p.k me ortake Gezim Hajdini dhe "Union Group "sh.p.k dhe me administrator Gezim Hajdini.

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 3.502.441 leke,I ndare 15% te kapitalit e zoteron ortaku Gezim Hajdini ose 525.366 leke.dhe 85 % te kapitalit e zoteron ortaku "Union Group "sh.p.k me administrator Niko Leka ose 2.977.075 leke

Aktualisht Asambleja e Ortakeve te shoqerise"UNION TRAVEL CO" sh.p.k me vendimin date Nr 12 dt 25.05.2005 ka vendosur :

1.Te shtoje kapitalin e shoqerise
2.Caktimin e ekspertit Bujar Bendo per vleresimin e kapitalit .
3.Depozitimin e ketyre ndryshimeve ne regjistrin tregtar.

Te depozitohet kerkesa, dt 18.7.05

Ne keto kushte kerkoj depozitimin e ketyre ndryshimeve prane regjistrit tregtar.

Vendimi i Asambl. Nr 12 dt 25.5.05
Licensa Nr 79 dt 18.4.00
TEKA-5

**KERKUES**

Gezim Hajdini

UNION TRAVEL CO
UT Co
TIRANA ALBANIA

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**SHOQERIA TREGTARE**
**"UNION TRAVEL CO" SH.P.K**

**V E N D I M**
ASAMBESE SE ORTAKEVE
**NR 12 DATE 25.05.2005**

Shoqeria"UNION TRAVEL CO"**sh.p.k** eshte regjistruar si person juridik me vendimin Nr 20201 date 28.10.1998 te Gjykates se Rrethit Tirane.

Sot ne mbledhjen e date 25.05.2005 ,Asambeja e Ortakeve te shoqerise **"UNION TRAVEL CO"Sh.p.k** mori ne shqyrtim aktivitetin e shoqerise dhe ecurine e saj ne te ardhmen dhe ne perputhje me statutin dhe ligjin:

**V E N D O S I :**

3. Te shtoje kapitalin e shoqerise.
4. Te caktoje si ekspert per vleresimin e kapitalit z.Bujar Bendo
   Depozitimin e ketyre ndryshimeve ne regjistrin tregtar.

**ASAMBLEJA E ORTAKEVE**

| | |
|---|---|
| **Gezim Hajdini** | **"Union Group "sh.p.k**<br>**Administrator**<br>**Niko Leka** |

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**DHOMA E NOTERISE TIRANE**
**NR.** 8372 **REP.**
**NR.** 2028 **KOL**

# V E R T E T I M

Sot me date 18.7. 2005,para meje noterit public
G. Xholi ,u paraqiten personalisht ;

**Gezim Hajdini** dhe **"Union Group "sh.p.k**, e perfaqesuar nga administratori **Niko Leka** te identifikuar prej meje nepermjet pasaportave perkatese;madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar , me cilesine e ortakeve te shoqerise"UNION TRAVEL CO"sh.p.k te cilet me deklaruan se dokumentin e mesiperm e kane redaktuar jashte kesaj zyre me vullnetin e tyre te lire dhe e nenshkruan ate para meje . Une noteri e vertetoje ate sipas ligjit.

**N O T E R I   P U B L I K**

20201/3

# K E R K E S E

**KERKUES:** Gezim HAJDINI, ne cilesine e Administratorit te shoqerise "UNION Travel Co" shpk. Tirane

**OBJEKTI**: Pasqyrimin ne Regjistrin Tregetar prane kesaj Gjykate te Kontrates te shitjes Nr.4581 Rep. dhe Nr.1607 Kol, dt 20 /12/2004 per transferimin e pjeseve te ortakut Genc CANO tek ortaku tjeter I po kesaj shoqerie "UNION GRUP" shpk Tirane ,duke bere edhe ndryshimet perkatese ne Regjistrin Tregetar

Kerkesa bazohet ne nenin 21 te ligjes nr.7632 dt.4.11.1992 "Per dispozitat qe regullojne Pjesen e pare te Kodit Tregetar.

## GJYKATES TE SHKALLES TE PARE

***Tirane***

Shoqeria "UNION Travel Co" shpk, eshte nje shoqeri tregetare e tipit shpk e regjistruar prane Regjistrit Tregetar te kesaj Gjykate me vendimin gjyqesor nr.20201 dt 28/10/1998.

Shoqeria ka per ortake :

1. **"UNION GRUP"** sh.p.k. Tirane, zoterues I 400 pjeseve,me vlere 20.000 USD qe perbejne 80% te kapitalit themeltar.
2. **Gezim HAJDINI**,zoterues I/ 75 pjeseve,me vlere 3750 USD,qe perbejne 15 % te kapitalit themeltar.
3. **Genc CANO**, zoterues I 25 pjeseve,me vlere 1250 USD, qe perbejne 5 % te kapitalit themeltar.

Me kontraten e shitblerjes noteriale me nr4581 Rep. dhe nr 1607 Kol. te dt. 20/12/2004 ortaku Genc CANO ka shitur teresisht pjeset e veta tek shoqeria tregetare "UNION GRUP" shpk,e cila pas ketij transaksioni behet ortaku qe zoteron 425 pjese, ne vlere 21.250 USD, qe perben 85 % te kapitalit themeltar te shoqerise "UNION Travel Co" shpk Tirane. .

Ne keto rrethana kerkojme qe te behet pasqyrimi ne Regjistrin Tregetar te kesaj Gjykate I kesaj Kontrate shitje,ku te pasqyrohet ndryshimi ne kete shoqeri i pjeseve te ortakut "UNION GRUP" shpk..

Tirane me 20 /12/ 2004

Administratori

Gezim HAJDINI

# V E N D I M

I

ASAMBLESE TE JASHTEZAKONSHME TE SHOQERISE "**UNION GRUP**" sh.p.k.

Asambleja e jashtezakonshme ortakeve te shoqerise "UNION GRUP" shpk,e mbledhur sot ne date 17/12/2004 ne seline e shoqerise,duke formuar kuoriumin e nevojshem per marrjen e vendimeve,morri ne shqyrtim oferten e bere nga zoti Genc CANO, ortak ne shoqerine "UNION Travel Co" shpk.dhe zoterues i 25 (njezet e pese) pjeseve te kapitalit te saj themeltar,ne nje vlere praj 1250 (njemije e dyqind e pesedhjete) USD, per shitjen e tyre shoqerise tone..

Ortaket e gjejne kete transaksion te dobishme per interesat e shoqerise dhe ne keto rrethana:

## VENDOSEN

1. ***Te pranojne oferten*** per blerjen ,prej zotit Genc CANO, zoterues i 25 (njezet e pese) pjeseve te Kapitalit Themeltar te shoqerise "UNION Travel Co" sh.p.k. ne vleren prej 1250 (njemije e dyqind e pesedhjete ) USD.

2. **Te mandatojne** administratorin e shoqerise Z.Niko LEKA te kryeje veprimet e nevojshme noteriale per nje transaksion te tille prane Zyres noteriale.

ORTAKET

Niko LEKA

Edmond LEKA

Eduard SHIMA

Varuzhan PIRANIANI

Gjergji MISHA

Adrian SHEHU

REPUBLIKA E SHQIPERISE
N O T E R I A
Nr. 4614 Rep.
Nr. 1626 Kol

Caenaq fuelle n'sperso
Kokoli

**VERTETIM NENSHKRIMI**

Sot ne daten 20 /12/ 2004, une notere Eriketa Kokoli,notere ne Tirane,me Seli ne rrugen e Durrsit,vertetova firmen e **Z.Edmond LEKA**,I biri I Vlashit dhe I Margarites,lindur ne Tirane me 17.05.1963,banues Tirane,rruga "Sulejman Delvina" Pall.29.shk.15,Ap.89,me numur pasaporte 0126431, **Niko LEKA**,I biri I Vlashit dhe I Margarites,lindur ne Tirane me 31.03.1961,banues ne banesen e mesiperme,me numur leternjoftimi AZ 086175; **Adrian SHEHU**,I biri I Ramazanit dhe I Ernestes,lindur ne Tirane me 11.08.1961,banues Tirane,rruga "Sami Frasheri",Pall.9,shk.2,Ap.13,I njohur personalisht; **Varuzhan PIRANIANI**,I biri I Vahramit dhe I Enenit,lindur ne 22.03.1957,banues Tirane,rruga "Muhamet Gjollesha", Pall.14, Ap.24,me numur pasaporte AZ 089508; **Eduard SHIMA**,I biri I Fejziut dhe I Haxhirese,lindur ne Tirane me 06.11.1960,banues Tirane,rruga "Myslym Shyri",pall.55/1.shk.3,ap.23,me numur pasaporte 0321631, te vene ne kete vendim te Asamblese te ortakeve.

Une noteri pasi e gjeta konform ligjes e vertetova si me poshte.

N O T E R I
ERIKETA KOKOLI

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE

Nr. 458 Rep.
Nr. 1698 Kol

## KONTRATE SHITJE

Sot ne daten 20/12/2004,ne qytetin e Tiranes,para meje noteres Eriketa KOKOLI,u paraqiten palet e meposhtme:

1. **Z.Genc CANO**, i biri i Naxhiut ,lindur ne Tirane me 30.07.1963,banues Tirane, madhor,me zotesi te plote juridike per te vepruar,me numur leternjoftimi QH 356919 ( ne vazhdim i quajtur "Shitsi")

2. Shoqeria **"UNION GRUP"** shpk,regjistruar si person juridik me vendimin e Gjykates te Rrethit Tirane nr.26016 dt.25.06.2001,perfaqesuar ketu ne baze te vendimit te Asamblese te Ortakeve dt.20 /12/2004 nga z.Niko LEKA, i biri Vlashit,lindur ne 31.03.1961.,banues Tirane,me zotesi te plote juridike per te vepruar ,i njohur personalisht prej meje ( ne vazhdim i quajtur "Blersi")

Palet e mesiperme kerkuan te redaktohet kjo Kontrate Shitje me permbajtje si me poshte:

Shitesi eshte njeri prej ortakeve te shoqerise "UNION Travel Co" shpk , e regjistruar prane Gjykates te Shkalles te Pare Tirane me nr. 20201 vendimi date 28.10.1998 dhe disponon aty 25 (njezet e pese) pjese me numur rendor 476-500, ne vlere 1250 (njemije e dyqind e pesedhjete) USD ,qe perfaqesojne 5 (pese) % te Kapitalit Themeltar te kesaj shoqerie.

Shitsi i shet Bleresit te gjitha pjeset e zoteruara prej tij ne Kapitalin Themeltar,sic specifikohen me siper, te gjitha keto te shlyeshme kundrejt vleres 1250 (njemije e dyqind e pesedhjete) USD.

Bleresi eshte dakord t'i bleje keto 25(njezet e pese) pjese te Kapitalit Themeltar kundrejt vleres 1250 ( njemije e dyqind e pesedhjete) USD

Duke qene se palet kane shlyer detyrimet reciproke ndaj njeri tjetrit jashte kesaj Zyre,pas neneshkrimit te kesaj Kontrate Shitje,shoqeria UNION GRUP shpk behet pronar I ligjshem I ketyre 25 (njezet e pese) pjeseve dhe se bashku me pjeset qe ajo ka ne kete shoqeri,si ortak I saj, perfundimisht zoteron 425 (katerqind e njezet e pese) pjese,ne vlere 21.250 (njezet e nje mije e dyqind e pesedhjete) USD,pra 85( tetedhjete e pese) % te kapitalit themeltar te shoqerise.

Kjo kontrate pasi ju lexua paleve me ze te larte,u kuptua prej tyre dhe u gjend ne perputhje me vullnetin e tyre te lire dhe te pavesuar,neneshkruhet regullisht prej tyre perpara meje Noteres.

Une Noterja pasi kontrollova te gjitha dokumentat perkatese e vertetoj kete kontrate Shitje sipas ligjes.

SHITESI

BLERESI

Niko Loka

NOTERI

ERIKETA KOKOLI

**D E K L A R A T E**

Si ortak i shoqerise "UNION GRUP" sh.p.k. jap pelqimin qe kjo shoqeri te bleje prej z. Genc Cano, 25 pjeset qe ai zoteron ne shoqerine "UNION TRAVEL CO" sh.p.k. ne vlere $1250 qe I korrespondon 5% te kapitalit te tij themeltar.

DEKLARUESI
Gjergji Misha

13/06 2014 22:38 FAX 001

(3)

20201/2

3 A shorkoj 07 03 2002

07 MAR. 2002

# KERKESE

**KERKUES:** Shoqeria tregetare "UNION Travel Co"shpk. perfaqesuar nga Z.Gezim HAJDINI, Administrator I saj.

**OBJEKTI:** Pasqyrimin ne Regjistrin tregetar te Venndimit te Asamblese te jashtezakonshme te ortakeve te kesaj shoqerie dt 24.11.2001 per ndryshimin e ortakut te vjeter UFT shpk me ortakun e ri UNION GRUP shpk,duke bere edhe ndryshimet perkatese.

Kerkesa bazohet ne nenin 21 te ligjes nr.7632 dt.4.11.1992 "Per dispozitat qe rregullojne Pjesen e pare te Kodit Tregetar.

**GJYKATES TE RRETHIT**

***Tirane***

Shoqeria jone eshte nje shoqeri tregetare e tipit shpk e regjistruar prane Regjistrit Tregetar te kesaj Gjykate me vendimin gjyqesor nr.20201 dt 28.10.1998,ndryshuar me vendimin nr.20201/1 dt.26.06.2000

Nje prej ortakeve te shoqerise ish edhe UNIONI FINANCIAR Tirane (UFT) shpk.

Me kontraten e shit blerjes noteriale me nr3504 Rep. Dhe nr.442 Kol. te dt.22.12.2001_ky ortak ka shitur asetet e veta tek shoqeria tregetare UNION GRUP shpk

.Per kete veprim juridik shit blerje eshte dhene edhe pelqimi yne me vendimin e Asamblese te ortakeve te dt.24.11.2001.

Ne keto rrethana kerkojme qe te behet pasqyrimi ne Regjistrin Tregetar te kesaj Gjykate I Vendimit te Asamblese te ortakeve te shoqerise tone dt.24.11.2001 per ndryshimin ne kete shoqeri te ortakut te vjeter UFT shpk. me ortakun e ri UNION GRUP shpk.ne po ato kuota kapitali.

Tirane me 01/03/2002

Administratori

Gezim HAJDINI

Gezim Hajdini

# UNION GRUP

# VENDIM

Asambleja e ortakeve te shoqerise UNION GRUP shpk.Tirane e mbledhur sot ne date 23/Nentor/01....... mori ne shqyrtim "Oferten e bere nga shoqeria UNIONI FINANCIAR TIRANE shpk per shitjen e aseteve te saj qe ajo ka tek shoqerite IDA sha, UNION TRAVEL shpk dhe ADN shpk, te specifikuara ne listen bashkengjitur kesaj oferte, dhe pasi e gjeti te dobishem per interesat e shoqerise, nje transaksion te tille:

**VENDOSI**

1. Te pranoje oferten per blerjen e aseteve te shoqerise UNIONI FINANCIAR TIRANE shpk. ne kuotat dhe vlerat e paraqitura ne te.

2. Te mandatoje administratorin e shoqerise Z. Eduard SHIMA per te kryer prane Zyres noteriale dhe regjistrit tregetar te Gjykates Tirane te gjitha veprimet e nevojshme juridike.

ORTAKET.

Edmond LEKA

Niko LEKA

Eduard SHIMA

Gjergj MISHA

Adrian SHEHU

Varuzhan PIRANIAN

PULLE TAKSE
100 LEKE
R.SHQIPERISE

REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERIA TIRANE
Nr. 1106 Rep. Dt. 12.03.2002
VERTETIM
Vërtetohet se fotokopja është e njëjtë me origjinalin
e Paraqitur nga Kloel Shelli
Nr. Pasap

Tirane me 23/Nentor/01...

NOTERE
ERIKETA KOKOLI

Rr."Ismail Qemali", Nr.32/1
Tirane Shqiperi
Tel/Fax: +355 4 24 76 02

REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERIA
Nr. 3508 Rep.
446 kol

VERTETIM NENSHKRIMI

Sot ne daten 22.12.2001,une notere ***Eriketa Kokoli***, notere ne Tirane, ish Gjykata e Vjeter, rruga "Durresit"vertetova firmen e **Niko Leka,** i biri i Vlashit dhe i Margarites, lindur ne 31.03.1961, banues ne Tirane, Rruga"Sulejman Delvina"Pall.29,shk.15,ap.89,i njohur personalisht prej meje noteres,**Edmond Leka**, i biri i Vlashit dhe i Margarites, lindur ne Tirane me 17.05.1963,banues ne Tirane, Rruga"Sulejman Delvina"pall.29,shk.15,ap.89, i njohur personalisht prej emje noteres,**Adrian Shehu**, i biri i Ramizit dhe i Ernerstes,lindur ne Tirane me 11.08.1961,banues ne Tirane,Rruga"Sami Frasheri" pall.9, shk.2,ap.13,i njohur personalisht,**Varuzhian Piranian**,lindur ne 22 mars 1957,banues ne Tirane,Rruga"Muhamet Gjollesha"pall14,shk.41,ap.24,i njohur personalisht, dhe **Eduard Shima**,i biri i Fejziut dhe i Haxhirese,lindur ne Tirane me 1.11.1960,banues ne Tirane, Rruga"Myslym Shyri",i njohur personalisht,te vene ne kete Vendim te marre me shumice votash
.Une noteri pasi i gjeta konform Ligjes e vertetova si me poshte.

NOTER
*ERIKETA KOKOLI*

# DEKLARATE

UNE I NENSHKRUARI GJERGJI MISHA, I BIRI I NIKOS DHE SOFIKES, LINDUR NE BUKURESHT (RUMANI) ME DATE 11. 05. 1957, ME ADRESE BANIMI NE RR. SAMI FRASHERI, PALL. 13, SH.2, AP. 13, TIRANE, NE CILESINE E ORTAKUT TE DYFISHTE DHE ME PJESMARRJE TE NJEJTE PREJ DHJETE PERQIND NE TE DY SHOQERITE „UNIONI FINANCIAR TIRANE SHPK." DHE „UNIONI GRUP SHPK":

DEKLAROJ NE PERGJEGJESINE TIME TE PLOTE DHE ME VULLNETIN TIM TE LIRE SE JAM VENE NE DIJENI TE AKTEVE TE TRANSFERIMIT TE ASETEVE QE „UNIONI FINANCIAR TIRANE SHPK." ZOTERON NE FORMEN E PJESEMARRJEVE TEK SHOQERITE „IDA SHA.", „UNION TRAVEL SHPK." DHE „ADN SHPK", TEK SHOQERIA „UNION GRUP SHPK" DHE KAM DHENE PELQIMIN TIM PER KETO TRANSFERIME.

GJERGJI MISHA

VJENE, 19 DHJETOR 2001

Gjergji Misha

AMBASADA E REPUBLIKES SE SHQIPERISE
BOTSCHAFT DER REPUBLIK ALBANIEN
A-1190 Wien An den Langen Lüssen 1/6/1
*Tel.:* 0043 1 328 8656 *Fax.:* 0043 1 328 8658

Prot. 715/01

Viene me, 19.12.2001

## VERTETIM

Sot me date 19.12.2001 u paraqit prane zyres Konsullore qytetari Gjergji MISHA, datelindja 11.05.1957 Bukuresht, mbajtes i pasaportes shqiptare Nr. 0316200, me zotesi te plota juridike i cili firmosi rregullisht Deklaraten e mesiperme.

PULLE TAKSE 100 LEKE R. SHQIPERISE

Per Zyren Konsullore

Elida VASO

REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERIA TIRANE
Nr. 1164 Rep Dt. 12.03.2002
VERTETIM
Vërtetohet se fotokopja është e njëjtë me origjinalin e Paraqitur nga ...
Nr. Pasap ...

NOTERE
ERIKETA KOKOLI

**REPUBLIKA E SHQIPERISE** **Nr.** 3504 **rep.**
**DHOMA E NOTEREVE TIRANE** **Nr.** 442 **kol.**

## KONTRATE - SHITJE

Sot me daten 22/12/2001 (dy mije e nje), ne qytetin e Tiranes para meje Noteres Eriketa KOKOLI, u paraqiten palet e meposhtme:

a) **Shoqërisë "UNIONI FINANCIAR I TIRANËS (UFT)" SH.P.K**, rregjistruar si person juridik me Vendimin e Gjykatës së Rrethit Tiranë Nr.9406 datë 06.03.1995, përfaqësuar këtu në bazë të Vendimit të Asamblesë së Ortakëve datë 23/11/2001 nga Administratori **z. Niko LEKA**, i biri i Vlashit dhe i Margaritës, lindur në Tiranë me 31/03/1961, banues në Tiranë rruga "Sulejman Delvina", P.29, Sh.15, Ap.89, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i Pasaportës Nr. AL 086175 **(në vazhdim i quajtur "Shitësi").**

b) **Shoqërisë "UNION GRUP" SH.P.K**, rregjistruar si person juridik me Vendimin e Gjykatës së Rrethit Tiranë Nr.26016 datë 25.06.2001, përfaqësuar këtu në bazë të Vendimit të Asamblesë së Ortakëve datë 23/11/2001 nga Administratori **z. Eduard SHIMA**, i biri i FEJZIUT, lindur me 6/11/1960, banues në Tiranë, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i Pasaportës Nr. 0321631 **(në vazhdim i quajtur "Bleresi").**

Palet e mesiperme kerkuan te redaktohet kjo kontrate - shitje si me poshte:

Shitesi eshte ortak ne Shoqerine Tregtare "UNION TRAVEL CO" SHPK dhe disponon 400 (katerqind) pjese, me vlere nominale 50 USS (pesedhjete) secila, qe perfaqesojne 80% te Kapitalit Themeltar te saj.

Shitesi i shet Bleresit te gjitha pjeset e zoteruara prej tij ne Kapitalin Themeltar, te gjitha keto te shlyeshme, kundrejt vleres 20,000USS.

Bleresi eshte dakort t'i bleje keto 400 (katerqind) pjese te Kapitalit Themeltar kundrejt vleres 20,000USS (njezet mije).

Duke qene se palet kane shlyer detyrimet reciproke ndaj njeri-tjetrit, pas nenshkrimit te kesaj Kontrate - Shitje, shoqeria "UNION GRUP" SH.P.K behet pronar i ligjshem i ketyre 400 (katerqind) pjeseve te kapitalit themeltar.

Kjo kontrate pasi iu lexua me ze te larte paleve te cilet e gjeten ne perputhje me vullnetin e tyre te lire dhe te pavesuar nenshkruhet rregullisht prej tyre perpara meje Noteres.

Une Noterja pasi kontrollova te gjitha dokumentat perkatese e vertetoj kete Kontrate - Shitje sipas ligjes.

**SHITESI** **BLERESI**

Niko Leka

NOTERE
ERIKETA KOKOLI

Eduard Shima

# UNIONI FINANCIAR TIRANE

## VENDIM – 01/11

Asambleja e ortakeve te UNIONIT FINANCIAR TE TIRANES shpk.,e mbledhur sot ne date 23/MENTOR/01., duke formuar kuoriumin e nevojshem per marjen e vendimeve, pasi shqyrtoj kerkesen e ortkeve ku propozohej transferta e aseteve te kesaj shoqerie (shitje) tek shoqeria UNION GRUP shpk. e gjeti kete propozim me vend per sa i perket prezantimit si kompani financiare e ne sherbim te menaxhimit me te mire te shoqerise, dhe ne rrethana te tilla:

**VENDOSI**

1. ***Te lejoje shitjen*** e aseteve te UFTshpk ne formen e pjesmarrjeve ne shoqerite IDA sha., UNION TRAVEL shpk, dhe ADN shpk tek shoqeria UNION GRUP shpk.Tirane

2. ***Te mandatohet*** administratori i shoqerise Z.Niko Leka te kryeje veprimet e nevojshme juridike prane Zyres noteriale dhe Regjistrit tregetar prane Gjykates se faktit Tirane.

PULLE TAKSE

ORTAKET:

Edmond LEKA

Niko LEKA

Eduard SHIMA

Gjergj MISHA

Adrian SHEHU

Varuzhan PIRANIAN

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
NOTERIA TIRANË
Nr 132 Rep Dt 22.03.2002
VËRTETIM
Vërtetohet se fotokopja është e njëjtë me origjinalin
NOTERE ERIKETA KOKOLI

Tirane me 23/MENTOR/01...

Rruga "Reshit Collaku", Pallati Shallvare, Nr. 2/18, Tirane, Shqiperi
Tel: +355 4 25 06 53, Fax: +355 4 25 06 54, www.unionifinanciar.com

REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERIA
Nr3504 Rep.
445 kol

VERTETIM NENSHKRIMI

Sot ne daten 22.12.2001,une notere *Eriketa Kokoli*, notere ne Tirane, ish Gjykata e Vjeter, rruga "Durresit"vertetova firmen e **Niko Leka,** i biri i Vlashit dhe i Margarites, lindur ne 31.03.1961, banues ne Tirane, Rruga"Sulejman Delvina"Pall.29,shk.15,ap.89,i njohur personalisht prej meje noteres,**Edmond Leka**, i biri i Vlashit dhe i Margarites, lindur ne Tirane me 17.05.1963,banues ne Tirane, Rruga"Sulejman Delvina"pall.29,shk.15,ap.89, i njohur personalisht prej emje noteres,**Ardian Shehu**, i biri i Ramizit dhe i Ernerstes,lindur ne Tirane me 11.08.1961,banues ne Tirane,Rruga"Sami Frasheri" pall.9, shk.2,ap.13,i njohur personalisht,**Varuzhian Piranian**,lindur ne 22 mars 1957,banues ne Tirane,Rruga"Muhamet Gjollesha"pall14,shk.41,ap.24,i njohur personalisht, dhe Eduard Shima,i biri i Fejziut dhe i Haxhirese,lindur ne Tirane me 1.11.1960,banues ne Tirane, Rruga"Myslym Shyri",i njohur personalisht,te vene ne kete Vendim te marre me shumice votash

.Une noteri pasi i gjeta konform Ligjes e vertetova si me poshte.

NOTER

NOTERE
ERIKETA KOKOLI

# VENDIM

Nr.1 date 10.11.1999

I

## ASAMBLESE TE JASHTZAKONSHME TE SHOQERISE "UNION TRAVEL Co." Shpk.

Sot me date 10.11.1999, ne zyrat e shoqerise UNION Travel Co.Shpk., u mblodh Asamblea e Jashtzakonshme e Ortakeve:

RENDI I DITES:
1. Zgjedhja e drejtuesit te Asamblese
2. Ndrrimi i selise te Shoqerise
3. Largim ortakesh, shitje pjese kapitali, pranim ortak i ri.

PJESEMARRJA:
Marrin pjese te gjithe ortaket e shoqerise UNION Travel Co.Shpk.

Me hapjen e mbledhjes u kontrollua pjesmarrja dhe meqenese ishin te pranishe m te gjithe ortaket u vazhdua me rendin e dites.

Per piken e pare; u propozua per te zgjedhur drejtuesin e Asamblese dhe u miratua unanimisht qe president i Asamblese te jete z. Gezim Hajdini.

